



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:  
Drejtësi në profilet “E drejtë penale”; “E drejtë ndërkombëtare”  
Kolegji Universitar “Bedër”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Evis ALIMEHMETI**

**Dr. Bledar MUSTAFARAJ**

**Tetor / 2022**



**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Msc në “Drejtësi në profilet “E drejtë penale”; “E drejtë ndërkombëtare”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në “Drejtësi” me profilet: “E Drejtë penale” dhe “E Drejtë ndërkombëtare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 10, datë 16.01.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 61, datë 09.02.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 39, datë 31.05.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 13 PAK
18	Numri i studentëve *	<b><u>Profili: E Drejtë Penale</u></b> 2020-2021 15 studentë 2021-2022 20 studentë  <b><u>Profili :E Drejtë Ndërkombëtare</u></b> 2020-2021 8 studentë 2021-2022 7 studentë
19	Komente / të tjera:	-

\* numri i studentëve është dhënë për një cikël studimi



## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Institucioni jopublik i arsimit të lartë “Kolegji Universitar “Bedër” (përmendur në vijim me inicialet KUB) është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (BEDËR), Tiranë”, të ndryshuar.

KUB është person juridik jofitimprurës, me karakter ndërkombëtar, i themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me seli të veprimtarisë në Tiranë.

KUB përbëhet nga dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit. Brenda Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë është ngritur dhe funksionon Departamenti i Drejtësisë. KUB është akredituar institucionalisht, ku me vendimin Nr. 101, datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, është vendosur për akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Kolegjit Universitar “Bedër”, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 9.11.2021.

Sa i përket programit të studimit Master i Shkencave në Drejtësi, në profilet “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare”, objekt vlerësimi, është hapur fillimisht me UMASH Nr. 10, datë 16.1.2012.

Ky program studimi është akredituar me Urdhrin Nr. 170, datë 20.4.2012 të Ministrisë së Arsimit, bazuar në Vendimin Nr. 323 të Këshillit të Akreditimit. Programi i studimit Master i Shkencave në Drejtësi, në profilet “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare” është riakredituar me Vendimin Nr. 39, datë 31.5.2019 të Bordit të Akreditimit, për 3 vite akademike, i vlefshëm deri më 30.9.2022.

Programi, objekt vlerësimi, synon t’u ofrojë studentëve mundësi për të thelluar njohuritë dhe për t’u specializuar në fushën e së drejtës, kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare, duke u njohur me nocionet juridike penale dhe ndërkombëtare. Gjatë dy viteve të studimit, synohet që studentët të thellojnë njohuritë e marra gjatë ciklit të mëparshëm të studimeve, me qëllim përgatitjen e juristëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Programi synon të nxisë studentët për t’u thelluar në punën kërkimore, shkencore dhe angazhimin e tyre si personel akademik (*Evidenca 4, neni 3*).

KUB ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin periodik të programit të studimit Master i Shkencave në Drejtësi në profilet “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare”, ku ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer lidhur me qëllime të riakreditimit.

### SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

- I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 39, datë 31.5.2019, janë si më poshtë vijon:**
  1. Institucioni, të sigurojë përshtatje të plotë midis lëndëve të programit dhe profilit të stafit akademik që angazhohet në mësimdhënie në ato lëndë;
  2. Institucioni, të rishikojë syllabuset me qëllim përmirësimin e kurrikulës në disa drejtime në mënyrë që të sigurohet koherenca e brendshme e syllabuseve si dhe koherenca me objektivat e programit në fjalë;



3. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi, me qëllim përfshirjen e praktikës profesionale/internshipit si element i detyrueshëm kurrikular;
4. Institucioni, të marrë masa konkrete për përditësimin e titujve në bibliotekë me qëllim që të reflektohet debati akademik bashkëkohor si dhe të sigurojë që literatura e detyrueshme për lëndët e programit të jetë e pranishme në bibliotekë;
5. Institucioni, të hartojë një plan të qartë veprimi lidhur me veprimtarinë e Komisionit dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe të marrë masa që aktivitetet monitoruese të kësaj njësie të jenë të mirëorganizuara me qëllim përmbushjen e detyrave sikurse parashikuar në aktet rregulluese;
6. Institucioni, të marrë masa për inkurajimin dhe përmirësimin e rezultateve të kërkimit shkencor, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore;

## II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Lidhur me rekomandimin e parë GVJ konstaton që institucioni ka bërë përpjekje për të afruar pranë programit sidomos personel akademik PAK të kualifikuar dhe në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi varion në kualifikime, ku disa janë edhe me eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies, me tituj dhe grada shkencore, apo edhe eksperiencë në pozicione të ndryshme dhe në sistemin e drejtësisë. GVJ konstaton se **ky rekomandim është i plotësuar plotësisht.**
2. Lidhur me rekomandimin e dytë GVJ konstaton se ka përmirësim të kurrikulës në raport me gjetjet e procesit të fundit të vlerësimit të jashtëm. Mund të ketë ende nevojë për vëmendje në planin mësimor të programit sidomos në profilin Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare. Për shembull, nuk është e qartë lidhja e lëndës me zgjedhje "Viktimologji" në programin mësimor të Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare, me objektivat e këtij programi. Në përgjithësi, në të dy profilet ka nevojë të qartësohen objektivat e lëndëve me emërtimin "Tema specifike në drejtësi". Për shembull nuk është e qartë pse lënda "Tema specifike në drejtësi" në drejtimin e drejtë penale është e detyrueshme ndërkohë që "Tema specifike në drejtësi" në drejtimin e të drejtës ndërkombëtare është me zgjedhje. GVJ konstaton se **ky rekomandim është kryesisht i plotësuar.**
3. Lidhur me rekomandimin e tretë, praktika profesionale është futur në program me 12 kredite. GVJ konstaton se **ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**
4. Lidhur me rekomandimin e katërt, konstatohet që institucioni zotëron një bibliotekë me larmi botimesh, ndër të cilët përfshihen dhe ato në fushën e së drejtës, në gjuhën shqipe dhe atë angleze (*Evidenca shtesë "Klasifikimi në Library Congress"*; *Evidenca shtesë "Lista e titujve që kanë hyrë vitet e fundit"*). Sipas dokumentacionit, biblioteka e institucionit siguron një gamë të gjerë titujsh, rreth 26 000, të përzgjedhur në përputhje me programet e studimit të ofruar nga ky institucion. Gjithashtu, institucioni ka siguruar akses pa pagesë për studentët në bibliotekën online "Jstore", në të cilën studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh, në përputhje me programin e studimit (*Evidenca 40*). Aksesin në bibliotekën online sigurohet në bazë të abonimit, është pa pagesë për përfituesit e saj si dhe mund të arrihet nëpërmjet shërbimit *wifi* të internetit, në të gjithë ambientet e IAL. KUB boton revistën periodike "Beder Journal of Humanities", ku ndër të tjera botohen dhe artikuj e punime në fushën e së drejtës. Këto

4



punime mund të aksesohen online: <http://bjh.beder.edu.al/>. Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe angleze, garanton përmbushjen e objektivave të programit për studentët (*Evidenca shitesë "Lista e titujve që kanë hyrë vitet e fundit"*). GVJ konstaton se **ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

5. Lidhur me rekomandimin e pestë, konstatohet që institucioni ka hartuar dhe miratuar në funksion të sigurimit të cilësisë Rregulloret për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të Përhershëm të Cilësisë dhe të NJSBC-së (*Evidencat 8 dhe 10*), po ashtu Rregulloren e ankesave dhe vlerësimeve (*Evidenca 11*). Në RVB si dhe gjatë takimit të zhvilluar në institucion me përfaqësuesit e NJSBC-së, u referua se është hartuar plani i veprimit, sipas rekomandimit të mëparshëm, ku i jepet një garanci më e madhe ndjekjes dhe marrjes së masave konkrete për përmirësimin e cilësisë institucionale (*Evidenca shitesë "Shënimet Drejtësi Bedër"*). Në aktet e vënë në dispozicion nuk rezulton një plan veprimi mbi veprimtarinë e Komisionit dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i hartuar. GVJ konstaton se **ky rekomandim është plotësuar kryesisht.**
6. Lidhur me rekomandimin e gjashtë, dy vitet e fundit akademike kanë paraqitur para të gjitha institucioneve të arsimit të lartë sfida ndaj planifikimit dhe mbajtjes së aktiviteteve të karakterit shkencor në kushtet e masave të marra kundër pandemisë. Në kushte të tilla është e vështirë të vlerësohet në mënyrë thelbësore mbi këtë çështje; sidoqoftë mund të thuhet institucioni është angazhuar në fushën e kërkimit shkencor duke investuar në fushën shkencore në mënyrë të qëndrueshme, nëpërmjet organizimit të konferencave shkencore *proceedings* shoqëruar me botimin e *proceedings*, botimin periodik të dy revistave shkencore nga ana e Institucionit, etj. Institucioni gjithashtu ka bërë përpjekje për të rritur kapacitetet shkencore nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si pjesë e programit të mobilitetit studentor Erasmus+. Në kontekst të sa më sipër, GVJ konstaton se **ky rekomandim është plotësuar plotësisht**, por duhet të qëndrojë në objektivat kryesore e të vlerësueshëm në vazhdimësi nga ana e Institucionit.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.



Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Evis Alimehmeti, eksperte e GVJ, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert i GVJ (të caktuar me urdhrin Nr. 32, datë 23.3.2022, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL. Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, të zhvilluar në datë 15 Prill 2022 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga KUB në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në profilet: E drejtë penale dhe E drejtë ndërkombëtare, gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë institucionin për të arritur objektivat në bazë të kriterëve të sistemit të standarteve.

Kolegji Universitar “Bedër” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.08.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 107/11 Prot, datë 02.08.2022. Kolegji Universitar “Bedër” përcjell në ASCAL më datë 10.08.2022, me anë të shkresës me Nr. 216/1 Prot., datë 08.08.2022, “Komente në lidhje me draft raportin”.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

**1. Për Komentin që i përket standardit I.3, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit të bërë duke pasur jo karakter gjetjeje, por nxitje të mbajtjes në vëmendje të ndryshimeve ligjore mbi programet e integruara që prekin të gjitha institucionet që ofrojnë programe në fushën e drejtësisë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**2. Për Komentin që i përket standardit I.3, kriteri 6:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me nevojën e mbajtjes në fokus në organizimin e praktikës profesionale të përmbushjes së objektivave të programit, objektiva të cilat sipas akteve të institucionit, strategjisë dhe vlerësimit të nevojës së tregut, lidhen me aftësimin e studentëve në dy degët e posacme të së drejtës. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**3. Për Komentin që i përket standardit II.1, kriteri 4:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar që observimet lidhen me qartësimin e natyrës së lëndëve të ofruara, drejtimet e lëndëve të cituara, arsyet e ndryshimit të statusit të lëndës “Tema Specifike në Drejtësi” nga e detyrueshme në një drejtim programi në lëndë me zgjedhje në drejtimin tjetër, dhe ardhjen në ndihmë me shembullin e disiplinave klinike të cilat përfshijnë edhe trajnim teorik përveç atij praktik dhe mund të shërbejnë për të adresuar lëndë të tilla me shtrirje kaq të gjerë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



#### **4. Për Komentin që i përket standardit II.5, kriteri 2:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar se, sipas *Evidenca 58*, me titull "Stafi i angazhuar në programin e studimit", në program angazhohen në mësimdhënie edhe personel akademik jo efektiv me gradën Msc. Tabela në *Evidenca 64* përfshin vetëm titullarët e lëndëve në një drejtim të programit, të cilët mbulojnë disa lëndë të programit si titullarë. Informacioni i marrë nuk përmban dallime në PAK me gradë Msc si lektorë të ftuar, kategori e cila në cdo rast nuk njihet nga kuadri ligjor në fuqi me kapacitet të tillë. Vënë në këtë kontekst, **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. Sidoqoftë, GVJ, ka shprehur vlerësimin në tekst për përpjekjet e qarta e të vazhdueshme të Institucionit për t'iu afruar balancës së duhur, megjithë vështirësitë që kanë hasur përgjithësisht të gjitha institucionet e arsimit të lartë me këtë kriter, në kuadër të mbylljes së plotë të programeve doktorale përgjatë 10 viteve të fundit.

#### **5. Për Komentin që i përket standardit II.5, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke pasur karakter nxitës për mbajtje në vëmendje të objektivave që i vlerëson si të tilla dhe vetë institucioni. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon**.

#### **6. Për Komentin që i përket standardit IV.3, kriteri 1:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport lidhur me sipërfaqen e parkimit dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e cila gjatë vizitës rezultoi e pjesshme. Nga aktet e vënë në dispozicion, të cilët paraqesin të dhëna për mjediset e institucionit (*Evidenca 68*), nuk ka të dhëna lidhur me sipërfaqen e parkimit. Kjo sipërfaqe nuk u përmend as gjatë vizitës së kryer në institucion. Komentin për këtë element, sipas të cilit KUB ka sipërfaqe parkingu prej 2 000 m<sup>2</sup> që përdoret nga stafi akademik, administrativ dhe nga studentët dhe ndodhet pas fushës së futbollit, IAL e ka shoqëruar me fotografi të parkimit, dërguar pranë ASCAL, në mbështetje të pretendimit të tyre (*Evidenca shtesë 1 "Foto nga parkimi"*). Në këto kushte, GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ. Në komentin e sjellë dhe fotografitë e sjella në rrugë elektronike, institucioni vë në dukje se për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në hyrje të godinës kryesore gjendet një rampë, ka ashensor si dhe janë marrë masa për vendosjen e një nyje të posaçme hidrosanitare në përdorim vetëm për këta persona (*Evidenca shtesë "Foto nga ambientet e institucionit për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"*). GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ.

#### **7. Për Komentin që i përket standardit IV.3, kriteri 5:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se pajisjet për një sallë gjyqi ishin vendosur në një ambient të hapur të godinës, jo në një sallë të destinuar posaçërisht për këtë qëllim, arsye për të cilën është sugjeruar që IAL të marrë masat e nevojshme për të krijuar sallën e gjyqit në përputhje me programin e studimit në drejtësi, për zhvillimin e gjyqeve imituese. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon**.



**8. Për Komentin që i përket standardit IV.6, kriteri 4:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport lidhur me raportet financiare. Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ, mbi bazën e akteve të administruar, nuk ka gjetur të dhëna mbi dokumentimin e raporteve financiare për tri vitet e fundit akademike. Këto të dhëna nuk janë të përmendura as në RVB. Për këtë arsye, GVJ ka përmendur vetëm procedurat që ndiqen për këtë qëllim në aktet e brendshëm të IAL (*Evidenca 1, neni 30*). Lidhur me këtë kriter, IAL ka vënë në dispozicion të GVJ projekt-buxhetin për tri vitet e fundit, dërguar pranë ASCAL (*Evidenca shitesë 9 "Projekt buxheti për 3 vite akademike"*). **Në këto kushte, GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ.**

**9. Për Komentin që i përket standardit V.2, kriteri 4:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport. Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ ka vënë në dukje se institucioni ka parashikuar procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj duke dhënë dhe referencat përkatëse. Në funksion të plotësimit të kriterit, GVJ ka sugjeruar që institucioni të hartojë një manual për punimin e temës, që do të lehtësonte në këtë drejtim punën e studentëve, por dhe të stafit akademik. Ky manual nuk gjendet i përfshirë në dokumentet që institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ, sipas akteve që ka dërguar në rrugë elektronike pranë ASCAL. Lidhur me këtë kriter, IAL ka parashtruar se institucioni ka një manual të miratuar për hartimin e temës, i cili është i publikuar online në faqen zyrtare të KUB. GVJ ka gjetur manualin përkatës, të publikuar online: [http://mco.beder.edu.al/uploads/docs/dc\\_30.pdf](http://mco.beder.edu.al/uploads/docs/dc_30.pdf). Në këto kushte, **GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ**, duke i sugjeruar institucionit që të tregohet më i vëmendshëm në të ardhmen në vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka hartuar dhe miratuar, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, gjatë procesit të akreditimit.

**10. Për Komentin që i përket standardit V.3, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar pjesërisht edhe ndryshimin e gjetjes në raport, për pjesën që bën fjalë për rregulloren për organizimin administrativ. Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ ka vënë në dukje se në aktet e miratuara të institucionit është gjetur vetëm rregullorja mbi organizimin akademik (*Evidenca 6*) dhe në funksion të përmbushjes së kriterit, GVJ ka sugjeruar hartimin e Rregullore për organizimin administrativ, sikundër përcaktohet në Rregulloren themelore, me qëllim që të përkufizohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit për planifikimin e karrierës. Kjo rregullore nuk gjendet e përfshirë në dokumentet që institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ, sipas akteve që ka dërguar në rrugë elektronike pranë ASCAL. Lidhur me këtë kriter, IAL ka parashtruar se institucioni ka të miratuar rregulloren për organizimin administrativ dhe në nenin 41 të saj, ndër të tjera, janë parashikuar detyrat e këshilltarit akademik (*Evidenca shitesë 3 "Rregullore mbi organizimin administrativ"*). **Në këto kushte, GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ**, duke i qëndruar sugjerimit tjetër që institucioni të hartojë një dokument të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës.



### **11. Për Komentin që i përket standardit V.7, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Në draft-raportin e përgatitur janë evidentuar përpjekjet pozitive të institucionit në drejtim të përmbushjes së këtij kriterit, por GVJ sugjeron që departamenti të intensifikojë përpjekjet e tij për të qenë pjesë e projekteve të tillë si “Jean Monnet”, etj., me qëllim fuqizimin e pjesëmarrjes në projekte kërkimore. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

### **12. Për Komentin që i përket standardit V.8, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport. Gjatë punimit të draft-raportit, GVJ ka vënë në dukje duke përshkruar detyrat e zyrës për planifikimin e karrierës. Detyrat e kësaj zyre përmenden dhe në nenin 41 të rregullores për organizimin administrativ, sjellë së fundmi nga institucioni (*Evidenca shtesë 3 “Rregullore mbi organizimin administrativ”*). GVJ, në vijim të analizës së bërë, ka sugjeruar miratimin e një rregulloreje specifike për zyrën e planifikimit të karrierës, pasi rrethi i detyrave të saj (neni 41 i rregullores për organizimin administrativ), nuk është e njëjta gjë me rregulloren specifike. Institucioni, në komentin e sjellë, ku ka përfshirë dhe kriterin 4 të këtij standardi, ka parashtruar se ka miratuar procedurën e praktikës profesionale si dhe procedurën për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës, duke sjellë në rrugë elektronike këto akte (*Evidenca shtesë 4 “Procedura e praktikës profesionale” (Evidenca 20); Evidenca shtesë 5 “Procedura për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës”*). Nga shqyrtimi i përmbajtjes së tyre, vlerësohet se aktet janë në funksion të qartësisë të procesit të punës që duhet të ndjekë zyra e planifikimit të karrierës, ndaj dhe duhet të pasqyrohen ndryshimet përkatëse në përmbajtjen e raportit. **Në këto kushte, GVJ vlerëson të paraqesë këtë fakt në përmbajtjen e RVJ.**

### **13. Për Komentin që i përket standardit VI.1, kriteri 2:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. GVJ ka rekomanduar, referuar standardeve të vendosur nga ASCAL, angazhimin dhe të bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Në komentin e tij, institucioni ka vënë në dukje se gjatë hartimit të raportit janë organizuar takime me grupin dhe me përfaqësues të institucioneve që bashkëpunojnë apo dhe të diplomuarit, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin justifikues që hedh dritë mbi këto takime. Në këto kushte, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky bashkëpunim në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, vlerësohet se gjetja qëndron. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

### **14. Për Komentin që i përket standardit VI.2, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë, duke ndrequr rekomandimin e bërë. GVJ ka rekomanduar hartimin dhe miratimin e udhëzuesit mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë, në bazë të kërkesave të nenit 14 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e NJSBC (*Evidenca 10*). Në komentin e tij, institucioni vë në dukje se metodat për kryerjen e vlerësimit, indikatorët dhe burimet e informacionit janë përfshirë në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve, dokument i vënë në dispozicion që në fillim të procesit nga institucioni (*Evidenca 11*). Gjatë shqyrtimit të këtij kriteri, konstatohet se institucioni ka parashikuar në aktet e brendshme instrumentet që do të përdoren për kryerjen e vlerësimit, ku përmenden vetëm anketat (*Evidenca 11, neni 3*). Gjithashtu, në të njëjtin dokument janë



specifikuar drejtimet dhe metodat për kryerjen e matjeve dhe vlerësimit si dhe indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik (*Evidenca 11*). Duke qenë se instrumentet dhe metodat shërbejnë për hartimin e raportit vlerësues të programit të studimit dhe përmirësimit të tij, GVJ-i qëndron rekomandimit, duke sugjeruar rishikimin e aktit, rregullorja për anketat dhe vlerësimet, ku të specifikohen qartë dhe në mënyrë të plotë metodat për kryerjen e vlerësimit, indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik e në tërësi instrumentet matës dhe vlerësues, përfshi dhe metodat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta. **Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht.**

#### **15. Për Komentin që i përket standardit VI.3, kriteri 3:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes, duke ndrequr rekomandimin e bërë. Metoda të drejtpërdrejta, të përmendura shprehimisht në aktet për sigurimin e cilësisë, nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë. Si metoda të tilla përmenden vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve nëpërmjet plotësimit të anketave përkatëse, vlerësimi i didaktikës nga kolegët. Metoda të tjera në këtë drejtim janë përmendur në f. 69 të RVB për promovimin e mësimdhënies: vlerësimet e kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, testime, vëzhgime në auditor, etj. GVJ vlerëson se institucioni duhet të specifikojë këto metoda në rregulloren për anketat dhe vlerësimet. **Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht.**

#### **16. Për Komentin që i përket standardit VI.3, kriteri 4:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes, duke ndrequr rekomandimin e bërë. Metoda të tërthorta të përmendura shprehimisht në aktet për sigurimin e cilësisë nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë. Në koment, institucioni shprehet se rregullorja e anketave dhe vlerësimeve përmban nene të veçanta, të cilat shprehin qartë përmbajtjen e tyre, por nuk referon nenet përkatës, që shtjellojnë metodat e tërthorta. Si metoda të tërthorta rezultojnë të përdoren: procesi i vlerësimit të studentëve, marrja e mendimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe për institucionin, marrja e mendimit nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si dhe strukturave përgjegjëse (*Evidenca 29; Evidenca 30; Evidenca 31; Evidenca 32*). GVJ vlerëson se institucioni duhet të specifikojë këto metoda në rregulloren për anketat dhe vlerësimet. **Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht.**

#### **17. Për Komentin që i përket standardit VI.3, kriteri 5:**

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. GVJ ka rekomanduar, referuar standardeve të vendosur nga ASCAL, angazhimin dhe të bashkëpunëtorëve e ekspertëve të jashtëm. Në komentin e tij, institucioni ka vënë në dukje se gjatë hartimit të raportit janë organizuar takime me grupin dhe me përfaqësues të institucioneve që bashkëpunojnë, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin justifikues që hedh dritë mbi këto takime. Në këto kushte, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky bashkëpunim në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, vlerësohet se gjetja qëndron. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi në profilet “E drejtë penale” dhe “E drejtë ndërkombëtare”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar akteve të programit në vlerësim, misioni i Kolegjit Universitar “Bedër” është përgatitja e individëve të kualifikuar nëpërmjet një filozofie arsimimi që synon të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor me standarde të larta të përgatitjes e studentëve me nivel bashkëkohor nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit, zhvillimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës; në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit si dhe integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor.  <i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Edhe pse ruajtja e vlerave kombëtare mund të identifikohet jo drejtpërsë drejti, duke iu referuar analizës së syllabuseve, mund të thuhet se programet e studimit në vlerësim zhvillojnë vlera kulturore e kombëtare.  <i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në përmbushje të këtyre objektivave, referuar parashikimeve në Rregulloren e programit Master Shkencor në Drejtësi, respektivisht në profilin “E drejtë ndërkombëtare” dhe “E drejtë penale”, programet kanë për qëllim arsimimin akademik dhe përgatitjen e studentëve me një formim të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive.



	<i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023; Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. Sidoqoftë përgatitja e studentëve me një formim të mirë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare ndihmon në krijimin e terrenit të favorshëm për zhvillime edhe të natyrës ekonomike lokale, kombëtare e rajonale.  <i>(Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Ssipas rregullores së programeve të studimit të ciklit të dytë, (neni 3), qëllimi i programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, për të ndërmarrë kërkime shkencore të vlefshme për specifikën shqiptare e atë ndërkombëtare.  <i>(Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.2

**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka miratuar Planin Strategjik 2018-2023 për zhvillimin e institucionit, hartuar nga Komisioni për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit të Kolegjit Universitar “Bedër”, e miratuar më 15.06.2017. Në Planin Strategjik të Institucionit identifikohen si misione në fushën e drejtësisë përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë institucioneve publike,



	<p>private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar.</p> <p><i>(Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Sipas Statutit dhe Planeve Strategjike të Institucionit, qëllimi i programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", me 2 profile është arsimimi akademik dhe përgatitja e studentëve me një formim të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në këto dy drejtme.</p> <p><i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Kolegji Universitar "Bedër", i licencuar për ushtrimin e aktivitetit si Institucion i Arsimit të Lartë" me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011. Me Urdhërin Nr. 10, datë 16.01.2012 "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë që përfundojnë me "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", nga ana e Institucionit është mundësuar zhvillimi i programit Master i Shkencave në "Drejtësi". Studentët që përfundojnë me sukses programin Master i Shkencave në "Drejtësi", me profil: "E drejtë penale" pajisen me diploma Master i Shkencave në "Drejtësi", me profil: "E drejtë penale". Studentët që përfundojnë me sukses programin Master i Shkencave në "Drejtësi", me profil: "E drejtë ndërkombëtare" pajisen me diplomë Master i Shkencave në "Drejtësi", me profil: "E drejtë ndërkombëtare". Programi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë i cili është njësi akademike shkencore brenda Fakultetit të Shkencave Humane.</p> <p><i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 05: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,</p>	<p>Programi i studimit merr në konsideratë nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Si program studimi është ndërtuar në ndjekje të ndryshimeve dhe zhvillimeve në fushën e së drejtës duke</p>




interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	pasur në fokus reformimin e sistemit penal dhe zhvillimet në të drejtë ndërkombëtare, një degë gjithmonë në zhvillim.  <i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.3 Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" dhe E drejtë Ndërkombëtare" në objektivat e tij synon të përgatisë profesionistë të dy fushave nëpërmjet përvetësimit të koncepteve bazë juridike në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare, aftësimin praktik të studentëve, përcjelljen e zhvillimeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare dhe përgatitja e specialistëve në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mori informacion në lidhje me ecurinë në vijim të këtij programi, pritshmëritë e institucionit dhe projeksionin për të ardhmen e afërt të tij në vlerësim të tendencës në rënie të interesit për programe të ciklit të dytë të studimeve në kuadër të programeve të integruara 5 vjeçare në drejtësi në përfundim të të cilave studentët pajisen me diplomën Master i Shkencave. Edhe sipas interlokutorëve është e pritshme që interesi për programet master në përgjithësi të bjerë; në vlerësimin e tyre për dy vitet e ardhshme kërkesa do të ketë sidomos nga brezi i fundit që do të diplomohet me diplomë Bachelor pranë Fakultetit të Drejtësisë së Kolegjit Universitar Beder, me përjashtim të vitit të ardhshëm akademik në të cilin diplomohet me diplome.</p> <p><i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti ka një studim për tregun e punës për programet e drejtësisë në lidhje me përthithjen e studentëve që përfundojnë programet e ciklit të dytë të studimeve dhe përshtatshmërinë e programeve të orfruara në drejtim të nevojave të tregut. Është e nevojshme që studimi të përqëndrohet në drejtimet e programit për të vlerësuar kërkesat e pritshmëritë e tregut sidomos në kuadër të rënies së pritshme të interesit për programet Master.</p> <p>Nga vizita e GVJ në institucion, GVJ mori informacion mbi kontaktet e institucionit me alumni të programeve të tij nëpërmjet klubeve e organizimeve të ditëve të hapura të punësimit, etj. Institucioni gjithashtu vazhdon komunikimet e drejtpërsëdrejta me përfaqësues të institucioneve që operojnë në fushat e programit për shpërndarjen e informacionit mbi programin duke nxitur ndjekjes së tij nga personeli i tyre. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion). (Evidenca nr. 86 – Studimi i tregut).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar këtij program studimi janë përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe specifike të tij. Po ashtu, struktura dhe përmbajtja e tij janë hartuar duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, si dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet. Qëllimi i programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” është të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, për të ndërmarrë kërkime shkencore të vlefshme për specifikën shqiptare e atë ndërkombëtare. Në përmbushje të këtyre objektivave, referuar parashikimeve në Rregulloren e programit Master Shkencor në Drejtësi, respektivisht në profilin e drejtë ndërkombëtare dhe e drejtë penale, programet kanë për qëllim formimin akademik dhe përgatitjen e juristëve me një bagazh të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive. GVJ rikujton përsëri nevojën për të mbajtur në vëmendje në drejtim të objektivave të programit uljen e ndjeshme të numrit të studentëve në kuadër dhe të organizimit të programeve të integruara 5-vjeçare në fushën e drejtësisë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 86 – Studimi i tregut, Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit</p>	<p>Siç përcaktohet edhe në aktet dhe dokumentacionin institucional, programi i studimit në elementët që përmban dhe strukturën e tij ka përpjekje për t’u qasur në trendet bashkëkohore, për të mundësuar edhe kualifikimin e mëtejshëm të studentëve në programe të cikleve të tjera të studimeve jashtë vendit. Programi përbëhet nga</p>



<p>të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>module/lëndë të veçanta dhe vlerësohet në kredite ECTS duke lehtësuar kështu njohjen e krediteve për efekt transferimi të studimeve. Sipas rregullores së programit gjuha e studimeve në profilin “E drejtë penale” dhe profilin “E drejtë ndërkombëtare” gjuha e programit të studimit është gjuha shqipe. Në takimet e GVJ në institucion, u përcoll informacioni që gjuha anglisht përdoret në tema të vecanta në disa lëndë, kryesisht të natyrës ndërkombëtare ose të së drejtës së krahasuar. U theksua gjithashtu nga ana e lektorëve mbështetja në literaturë të huaj dhe aksesit në informacion të avancuar në legjislacion e doktrinë të huaj nëpërmjet bibliotekës online të siguruar nga ana institucionit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor, Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Ky program studimi, ashtu si edhe programet e tjera që ofron Departamenti i Drejtësisë mbështeten në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë, të orientuar drejt Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Nuk rezulton të ketë një model programi studimi të huaj që është ndjekur. Sidoqoftë, institucioni ka një eksperiencë tashmë në treg në lidhje me programet e arsimit të lartë që mund të thuhet se ndihmon në zhvillimin e objektivave të programit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor, Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në instiucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Aftësimi profesional dhe angazhimi i studentëve në praktika profesionale është sjellë në program pas rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit. Praktika profesionale përbën 10% të krediteve të këtij program studimi me 12 ECTS) dhe zhvillohet në bashkëpunim me institucione dhe organizata partnere me të cilat Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim, p.sh. gjykata, prokurori, studio ligjore/zyrë avokatie, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi i Provës, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, OJF të ndryshme. Nga takimet e GVJ me studentët, vlerësohet se praktikatat realizohen edhe në institucione pa një aktivitet të dpd në fushat e programit si noteri apo institucione lokale. Fusha penale dhe ajo ndërkombëtare kërkon përqëndrimin në institucione të drejtësisë</p>



	<p>pënale, të diplomacisë, apo institucione qëndrore ku mund të vihet në kontakt me vendimmarrje të rëndësishme në këto dy drejtime.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor, Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 20- Procedura mbi praktikën profesionale, Evidenca nr. 85- Shembull - Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore).</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit gjuha e studimeve në programin "Master i Shkencave" në Drejtësi në profilin "E drejtë penale" dhe profilin "E drejtë ndërkombëtare" është gjuha shqipe. Në takimet e GVJ në institucion, u përcoll informacioni që gjuha anglisht përdoret në tema të vecanta të në disa lëndë, kryesisht të natyrës ndërkombëtare ose të së drejtës së krahasuar. U theksua gjithashtu nga ana e lektorëve mbështetja në literaturë të huaj dhe aksesit në informacion të avancuar në legjislacion e doktrinë të huaj nëpërmjet bibliotekës online të siguruar nga ana institucionit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor, Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 40: Marrëveshja për akses në JSTOR).</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Sipas të dhënave gjatë vizitës në institucion, institucioni përgatit dhe ruan dokumentacionin e programit përfshirë rregulloret, syllabuset, raportin vjetor, etj dhe në gjuhën angleze.</p> <p><i>(Minutat e takimeve të GVJ në instiucion)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


**Standardi I.4**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë është një nga Njësitë kryesore që e ka filluar veprimtarinë e vet me hapjen e këtij institucioni në vitin akademik 2011 – 2012. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë.</p> <p>Per sa i përket stafit akademik për programin e studimit në vitin akademik 2019-2020 referuar <i>Evidences 58</i>, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 22 pedagogë gjithsej, ku 9 janë PAE nga të cilët 1 nga kategoria Prof., 3 me gradën Dr/PhD, dhe të tjerët Msc dhe 13 janë PAK nga të cilët 2 nga kategoria Prof., 4 me gradën Dr/PhD, dhe të tjerët me Msc. Gjatë 2020-2021 janë angazhuar 28 pedagogë gjithsej nga të cilët 12 PAE nga të cilët 1 kategori Prof. 5 me gradën Dr/PhD, si edhe 4 asistente-lektore me Msc dhe 16 PAE dhe gjatë 2021-2022, 23 pedagogë gjithsej ku 10 janë PAE, nga të cilët 1 kategori Prof., 5 me gradën Dr/PhD, dhe të tjerët me Msc, dhe 13 PAK nga të cilët 2 nga kategoria Prof., 5 me gradën Dr/PhD, si edhe 7 asistente-lektore me Msc. Gjatë vitit 2021-2022, referuar <i>Evidences 58</i>, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 23 pedagogë gjithsej, ku 10 PAE, nga të cilët 1 nga kategoria Prof, 5 me gradën Dr/PhD, si edhe 4 asistente-lektore me Msc, dhe 13 PAK nga të cilët 1 Prof.Dr, 5 me gradën Dr/PhD, si edhe 7 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Departamenti i Drejtësisë ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. Sidoqoftë, sipas kërkesave ligjore, programet e ciklit të dytë të studimeve duhet të mbështeten në angazhimin e personelit akademik me grada e tituj. Gjatë këtyre viteve siç rezulton nga dokumentacioni i dorëzuar, kriteret ligjore që lidhen me angazhimin në ciklin e dytë të studimeve të personelit akademik me gradë dhe titull një peshë të rëndësishme për plotësimin e këtyre kërkesave e mban personeli akademik me kohë të pjesshme që angazhohet në programin e studimit. (<i>Evidenca nr. 64- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës, Evidenca nr. 65- Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program; Evidenca nr. 53- Numri i personelit akademik për cdo njësi bazë të fakultetit</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në drejtimin E drejtë Penale dhe E drejtë Ndërkombëtare është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Drejtësisë, si një nga programet e ciklit të dytë, që ky department ofron.</p> <p>Ky program është në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi (LAL dhe aktet nënligjore në zbatim të tij), me aktet e tjera rregullatore të Institucionit, si dhe në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, standartet dhe parimet e</p>



<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Gjithashtu, ky program është hartuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar - niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 05: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 09: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në drejtimin E drejtë Penale dhe E drejtë Ndërkombëtare është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Drejtësisë si dhe në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi (LAL dhe aktet nënligjore në zbatim të tij), me aktet e tjera rregullatore të Institucionit, si dhe në përputhje me Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Nuk është program ndërdisiplinar.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 06- Rregullore mbi Organizimin Akademik, Evidenca nr. 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk është përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe</p>	<p>Për një mbarëvajtje sa më normale të programit, institucioni ka organizuar ndarjen e punës së karakterit akademik dhe administrativ shoqëruar dhe me infrastrukturën e nevojshme në funksion të këtij program studimi. Gjatë vizitës së GVJ në institucion, interlokutorët evidentuan frymën bashkëpunuese midis strukturave dhe ndarjen efiksae të punës. Përgjegjësitë e njësisë bazë, kryesore dhe strukturave të tjera përgjegjëse për koordinimin e marrëdhënieve me studentët, etj janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e</p>



<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucionit si dhe në Rregulloren e Programit, atë të praktikave mësimore etj.</p> <p><i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 20: Procedura mbi praktikën profesionale, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar RVB për realizimin e objektivave të programit të studimit Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, Institucioni rezulton të ketë marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike kryesisht evropiane, në të cilat parashikohen shkëmbime të ekspertizës akademike dhe forma të tjera bashkëpunimi në fushat e përbashkëta të studimit. Gjithashtu, Institucioni ka zhvilluar bashkëpunime me Institucione të Arsimit të Lartë vendase publike dhe jo publike si Universiteti i Tiranës, Universiteti Epoka, Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu", Universiteti i Gjirokastrës "Eqerem Çabej", për qëllime shkëmbimi të stafit dhe studentëve, bashkëorganizim të aktiviteteve shkencore, etj. Marrëveshje janë lidhur dhe me institucione vendase për qëllime të realizimi të praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidenca nr. 48- Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar si nga takimet e GVJ gjatë vizitës në institucion, institucioni ka marrëveshjet bashkëpunimi me institucione qendrore e vendore që parashikojne kryerjen e praktikave profesionale, përfshirë edhe studentët e programeve të drejtësisë".</p> <p><i>(Evidenca nr. 48- Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale, Evidenca nr. 85- Shembull - Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës</p>	<p>Sipas informacionit të përcjellë gjatë takimeve të GVJ, realizimi i praktikave mbikqyret dhe menaxhohet nga departamenti nëpërmjet pedagogëve të ngarkuar me ndjekjen e praktikës së grupit përkatës të studentëve deri në realizimin e vlerësimit përfundimtar të studentit. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë lidhur me studio ligjore/zyra</p>




specifike të programit të studimit që ofron.	avokatie e noterie, subjekte biznesi, institucione qendore e vendore), institucione të drejtësisë (gjykata), OJF, etj,  <i>(Evidenca nr. 48- Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale, Evidenca nr. 85- Shembull - Shkresë drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Sipas informacionit të përcjellë gjatë takimeve të GVJ, zyra e Projekteve dhe Zyra e Karrierës e cila është përgjegjëse për lidhjen midis studentëve dhe punëdhënësve potencialë informon periodikisht studentët dhe personelin akademik për mundësitë e projekteve kërkimore, mobilitete, kualifikime e trajnime, etj. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion, RVB, Kriteri 5, Standarti I.5).</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe mbledhur për këtë program studimi, nuk rezulton të hartohet një raport i posaçëm analitik për përfitimet apo efektivitetin e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me institucione dhe aktorë të ndryshëm. Sidoqoftë Raporti vjetor i departamentit përfshin edhe reflektimin mbi efikasitetin e bashkëpunimeve institucionale sidomos për qëllimin e zhvillimit të praktikave profesionale apo duke sjellë propozime për bashkëpunime të reja me IAL vendase apo të huaja, etj.  <i>(Evidenca nr. 23-Model Raporti Vjetor, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore	Personeli akademik bën përpjekje për të rritur nivelin e tij të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve me rëndësi është edhe kërkimi shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Institucioni boton rregullisht 2 Revista shkencore, si dhe organizon Konferenca Shkencore apo dhe aktivitete ekstrakurikulare. Departamenti i Drejtësisë bashkëpunon dhe me Zyrën e Kërkimit Shkencor që bashkërendojë punën me



shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	<p>departamentin për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe kontribuon në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare.</p> <p><i>(Evidenca nr. 14- Rregullorja mbi kërkimin shkencor, Evidenca nr. 27- Lista e konferencave shkencore, Evidenca nr. 22- Procedura e mbështetjes së pjesmarrjes në konferenca nga KU Beder, Evidenca nr. 33: Plani i trajnimeve të personelit, Evidenca nr. 34- Marreveshje mobiliteti me programin Erasmus +)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, Zyra e Kërkimit Shkencor që harton dhe ndjek zbatimin e politikave të kërkimit shkencor. Përveç kësaj strukture, një Komision i Përhershëm mbikqyr progresin në e projekteve të kërkimit, aplikimet në process, etj.</p> <p><i>(Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 07-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë të ndryshëm vendas apo të huaj, Institucioni nxit e promovon zhvillimin e kapaciteteve shkencore të personelit akademik, organizohen periodikisht konferenca shkencore proceedings të të cilave botohen rregullisht, botimi i dy revistave shkencore nga ana e Institucionit, etj. Institucioni gjithashtu nxit rritjen e shkëmbimit, forcimin e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>(Evidenca nr. 14: Rregullorja mbi kërkimin shkencor, Evidenca nr. 22: Procedura e mbështetjes së pjesmarrjes në konferenca nga KU Beder, Evidenca nr. 27: Lista e konferencave shkencore, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	<p>Sipas dokumentacionit, në aktet që shoqërojnë cdo veprimtari kërkimore botuese është përfshirë klauzola për të drejtën e autorit dhe pronësisë intelektuale. <i>(Evidenca nr. 14: Rregullorja mbi kërkimin shkencor)</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	<p>Në lidhje me kualifikimin e stafit dhe me kërkimin shkencor institucioni mbështet stafin akademik efektiv për avancimin në kualifikimin e tyre si dhe në pjesëmarrjen në aktivitete brenda dhe jashtë vendit, por kjo nuk shoqërohet edhe me mbështetje financiare. Për më tepër, kjo ishte bërë më tepër mbi baza individuale. Aktualisht është bërë e mundur që përmes një marrëveshje në kuadër të</p>



	<p>programit Erasmus+ të mundësohet pjesëmarrja e stafit në shkëmbim/mobilitet.</p> <p><i>(Evidenca nr. 34: Marreveshje mobiliteti me programin Erasmus + Evidenca nr. 45: Plani i Aktiviteteve, Evidenca nr. 57: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Drejtësi” me profile: “E drejtë penale”; “E drejtë ndërkombëtare”, organizohet sipas sistemit me kohë të plotë sipas Urdhërit Nr. 10, datë 16.01.2012 <i>Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë që përfundojnë me “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”</i>. Programi ka për qëllim arsimimin akademik dhe përgatitjen e studentëve me një bagazh të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive. Programi realizohet me 120 ECTS.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i</p>	<p>Programi master në drejtësi ka si objektiva përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t’i shërbejnë</p>



<p>arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në një përmbledhje të arritjeve që synon programi master në të dy profilet, mund të thuhet se programet e profileve synojnë përvetësimin e koncepteve bazë juridike në fushën e të drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare, aftësimin praktik të studentëve dhe përcjelljen e zhvillimeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare dhe përgatitjen e specialistëve në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Mund të thuhet gjithsesi me kurrikulën e programit përgjithësisht se mund të arrihet një bazë e vlefshme edukimi për të diplomuarit në fushën e drejtësisë për qëllime të një karriere profesionale apo për të vijuar thellimin e studimit në programet të ciklit të tretë në fusha të lidhura me të drejtën ndërkombëtare dhe atë penale.</p> <p><i>(Evidenca nr. 03- Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ka përmirësim të kurrikulës në raport me gjetjet e procesit të fundit të vlerësimit të jashtëm. Sidoqoftë ka ende nevojë për vëmendje në planin mësimor të programit sidomos në drejtimin Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare. P.sh nuk është e qartë lidhja e lëndës me zgjedhje “Viktimologji” në programin mësimor të Master Shkencor në të Drejtë Ndërkombëtare, me objektivat e këtij programi. Në përgjithësi, në të dy programet ka nevojë të qartësohen objektivat e lëndëve me emërtimin “Tema specifike në drejtësi”. Nuk është e qartë pse lënda “Tema specifike ne drejtësi” ne drejtimin e drejtë penal është e detyrueshme ndërkohë që “Tema specifike në drejtësi” në drejtimin e të drejtës ndërkombëtare është me zgjedhje. Duket se këto lëndë kanë si objektivi zhvillimin e njohurive praktike, objektivi mjaft i rëndësishëm që ka dhe mbështetjen e studentëve. Sidoqoftë, u mungon qartësia në hapësirën e shtrirjes së tyre, mënyrën e organizimit të tyre, përzgjedhjen e temave, mbështetjen me burime etj. <i>GVJ sugjeron një model që mund të mbahej në konsideratë është Klinika e Ligjit, si lëndë, e cila mbështetet në një trajtim kazuesh/simulim rastesh të ndryshme por relevante për fushën e programit të studimit përkatës.</i></p>



	<i>(Evidenca nr. 39-Syllabuset e lëndëve të programit, Evidenca nr. 61-Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit).</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Rregullorja e programit Master i Shkencave në “Drejtësi”, përmban rregullat e funksionimit të këtyre programeve, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, kërkimin, praktikën, vlerësimin, diplomimin, etj. Në drejtim të organizimit formal, programi është në përshtatshmëri me parimet e kuadrit rregullator të arsimit të lartë, parimet e organizimit të cikleve sipas Kartës së Bolonjës. <i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit referuar legjislacionit për arsimin e lartë dhe akteve të brendshme rregullore të institucionit, organizohet në module/lëndë që vlerësohen në kredite ECTS. Struktura e këtij programi ndahet në disa disiplina kryesore (lëndë të detyrueshme, lëndë me zgjedhje, praktikë profesionale e teza), ku janë grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite mbi bazën e VKM-së Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar).  <i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61-Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Ky program realizohet me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Ai është i organizuar në bazë të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Praktika profesionale zë 10% të krediteve të këtij programi studimi, pra 12 ECTS.  <i>(Evidenca nr. 61-Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## Standardi II.2



**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë i cili, në përputhje me kërkesat e nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë, përbëhet nga katër Departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Drejtësisë;</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Islame;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave të Komunikimit;</li> <li>4. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze;</li> </ol> <p>Në bazë të nenit 19 të Statutit, dekanati i KU është organi kolegjal ekzekutiv i njësisë përkatëse, pra fakultetit. Dekanati përbëhet nga dekani, zëvendësdekani, përgjegjësit e njësisë bazë dhe administratori i njësisë kryesore. Neni 42 i Statutit përcakton funksionet dhe detyrat kryesore të dekanit; ai drejton dhe përfaqëson fakultetin, është anëtar i Senatit akademik, propozon drejtuesit e njësive bazë të fakultetit përkatës, emëron përgjegjësit e grupeve mësimore lëndore dhe ndërlëndore mbi propozimin e titullarit të njësisë bazë, kontrollon mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësitë bazë, në bazë të nevojave të fakultetit dhe zhvillimit të tij, i propozon rektorit vendet vakante dhe ndryshimet në numrin dhe pozicionet e burimeve njerëzore të fakultetit, për përgatitjen e procesit të rekrutimit, ngre komisionin ad-hoc të rekrutimit për fakultetin përkatës, etj. Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi një takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit. Në bazë të informacionit mbi stafin akademik rezultoi se Dekani i Fakultetit është me titullin “Profesor i Asocuar”, pra në përmbushje të kërkesave të nenit 42 (3) të Ligjit për Arsimin e Lartë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 06- Rregullore mbi Organizimin Akademik, Evidenca nr. 59- Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ zhvilloi një takim me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe Përgjegjësin e Departamentit të Drejtësisë. Në bazë të informacionit mbi stafin akademik rezultoi se Dekani i Fakultetit është me titullin “Prof. As.”, pra në përmbushje të kërkesave të nenit 42 (3) të Ligjit për Arsimin e Lartë. Personeli akademik i Departamentit të Drejtësisë përbëhet nga anëtarë me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme, specialistë të fushës juridike, me tituj e grada shkencore,</p>



	<p>magjistratë apo edhe staf me diplomën 'Master i Shkencave'. Në vitin akademik 2021-2022, në këtë departament janë aktivizuar 23 pedagogë, nga të cilët 10 janë personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe pjesa tjetër personel akademik me kohë të pjesshme (PAK).</p> <p><i>(Evidenca 58 – Evidenca e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit, Evidenca 54 – Numri i personelit akademik për njësinë bazë 56- Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit, Minutat e vizitës së GVJ-së)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Për të përmbushur objektivat e programit të studimit, Departamenti ka bërë përpjekje për të afruar personel akademik të kualifikuar në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. Sidoqftë, balanca në cdo vit akademik anon nga ana e personelit akademik me kohë të pjesshme, megjithëse është gati në raport të balancuar. Raporti mes PAE/PAK të anagzhuar në program nga ana e departamentit në vitin 2020-2021 është 40% PAE dhe 60% PAK, ndërsa për vitin akademik 2021-2022 është akademike është afërsisht 45 % PAE dhe 55% PAK. Nga PAE, në vitin akademik 2020-2021, 5 janë me gradën shkencore "Doktor", 1 me titull Prof. Dr dhe 6 me Msc. Në vitin akademik 2021-2022, 4 janë me gradën shkencore "Doktor", 1 me titull Prof. Dr dhe 4 me Msc. Departamenti ka bërë përpjekje për të reduktuar diferencën midis PAE dhe PAK.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe i Drejtësisë i cili, në përputhje me kërkesat e nenit 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë, përbëhet nga katër Departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Drejtësisë;</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Islame;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave të Komunikimit;</li> <li>4. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze;</li> </ol> <p>Departamenti i Drejtësisë ofron studime në tre programe, një të ciklit të parë bachelor, dhe dy të ciklit të dytë. Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik "Prof.As." ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, "Doktor i Shkencave". FSHHD në vitin e fundit akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij <b>61 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, 38 janë staf akademik efektiv ( PAE), dhe 23 staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Drejtësisë për vitin akademik 2021-2022, përfshin 23 pedagogë me 10 PAE, nga të cilët 1 nga kategoria Prof, 5 me gradën Dr/PhD, si edhe 4 asistente-lektore me Msc, dhe 13</p>



	<p>PAK nga të cilët 1 nga kategoria, 5 me gradën Dr/PhD, si edhe 7 asistente-lektore me Msc.</p> <p><i>(Evidenca 53 – Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë të fakultetit; Evidenca 54- Numri i personelit akademik për njësinë bazë)</i>  <i>(Evidenca shtesë Master i Shkencave në Drejtesi tabela me të dhënat për stafin akademik të fakultetit).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Stafi i angazhuar në këtë departament dhe që aktivizohet edhe në programin e studimit mbulon edhe praktikën profesionale, ndjekjen e projekteve studimore, etj.</p> <p><i>(Evidenca 58 – Evidenca e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit, Evidenca 56- Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit, Evidenca nr. 64- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës).</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Koordinimi në lidhje me programin e ciklit të dytë të studimeve realizohet në disa nivele: koordinatori i përgjithshëm i programeve të ciklit të dytë që emërohet nga Senati akademik; koordinatorët e programeve të ciklit të dytë që bashkërendojnë punën e të gjitha programeve të ciklit të dytë brenda IAL-së, të zgjedhur nga Komiteti shkencor (në mungesë të tij ky funksion i ngarkohet përgjegjësit të departamentit). Në nenin 11 të Rregullores së studimeve të ciklit të dytë janë rregulluar detyrat e Koordinatorit të departamentit për programet e ciklit të dytë që është njëherësh edhe sekretar i programit të studimit të ciklit të dytë me detyra sekretarike si komunikimin shkresor me organet e tjera të strukturës së brendshme të Kolegjit Universitar, me departamentet përkatëse, personelin akademik, studentët, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 43- Vendim i këshillit të departamentit për caktimin e koordinatorit të programit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesit të njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Sipas Rregullores së studimeve të ciklit të dytë, koordinatori ndjek ecurinë e procesit mësimor në lidhje me strukturën mësimore, orarin e lëndës e të provimeve, ecurinë e praktikës dhe mban dokumentacionin përkatës të këtyre proceseve. <i>(Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



**Standardi II.3**

**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të të dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni bashkë me dokumentacionin shtesë të kërkuar, si dhe komunikimit të realizuar gjatë vizitës në institucion, mund të thuhet së departamenti zotëron dhe disponon informacionet e nevojshme në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Shkencor në të drejtë ndërkombëtare dhe penale programeve të studimeve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 06- Rregullore mbi Organizimin Akademik, Evidenca nr. 14- Rregullorja mbi kërkimin shkencor, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në disa disiplina kryesore (lëndë të detyrueshme, lëndë me zgjedhje, praktikë profesionale e teza), me ngarkesën përkatëse në kredite mbi bazën e VKM-së Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. <i>(Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit organizohet në lëndë/ module, të vlerësuara me kredite ECTS sipas sistemit shqiptar e evropian, i ndarë në dy semestra, 2 vite akademike.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Organizimi i programit të studimit bëhet në vite akademike, dhe 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor. 1 ECTS baraz me 25 orë mësimore pune të studentit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese</i></p>



programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>(A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor)</p> <p>Plani mësimor, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë, orët në auditor/jashtë auditorit, ngarkesa e pedagogëve dhe mbulimi i lëndëve jepet në Tabelat e Aneks RVB .</p> <p>(Evidenca 58 – Evidenca e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit, Evidenca 56- Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit, Minutat e vizitës së GVJ-së)</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi i studimit mundëson marrjen e informacionit të nevojshëm për studentët që ndjekin këtë program studimi, që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, parashikuara këto edhe në rregulloren e këtij programi si dhe në Rregullorene ekuivalentimeve.</p> <p>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 14- Rregullorja mbi kërkimin shkencor, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 12: Rregullorja mbi transferimet).</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	<p>Sipas informacionit të marrë në institucion, përmbajtja e programit si dhe syllabuset përditësohen para fillimit të vitit akademik dhe miratohen nga ana e departamentit. Dokumentacioni ruhet pranë Departamentit. Në përditësimin e syllabuseve, pedagogu i lëndës ka përgjegjësinë kryesore. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, organizimin dhe statusin e akreditimit të programit. (Minutat e vizitës së GVJ-së)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>



<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare/ushtime dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në %) për veprimtaritë formuese është në pajtim me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Në dokumentacion e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në këtë program.  <i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Ndarja në kategori e veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, bën të mundur arrijten e objektiveve të programit. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurikula e tij mundëson thellim të njohurive dhe aftësive dhe ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat, profesione të lira. <i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arrijten e objektiveve formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi synon t’i përgjigjet nevojave të tregut për specialistë në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare nëpërmjet edukimit dhe pajisjes së studentëve me njohuri të avancuara të në këto dy degë të rëndësishme të së drejtës. Lëndët e ofruara në program përgjithësisht adresojnë objektivat formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, si program i ofruar në nivelin e avancuar të studimeve master shkencor, sipas përcaktimeve ligjore.  <i>(Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i>
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa	Për hartimin e programit të studimit është mbajtur si objektiv përgatitja e studentëve me një formim të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës



<p>në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>me individë të kualifikuar në fushat respektive. Duke marrë në konsideratë disa nga problematikat e shprehur më lart mbi natyrën e disa lëndëve të 2 drejtimeve të programit, mund të thuhet gjithsesi me kurrikulën e programit përgjithësisht se mund të arrihet një bazë e vlefshme edukimi për të diplomuarit në fushën e drejtësisë. Struktura e programit është bërë në përputhje me VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p><i>Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijten e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nuk evidentohet ndonjë model konkret se në cilat programe të universiteteve të njohura europiane është bazuar ky program studimi, sidoqoftë mund të thuhet se raportet midis disiplinave të formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijten e objektivave formues, gjithashtu edhe transferim të studimeve apo mobilitetin e studentëve, etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62-Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Çdo lëndë e këtij programi ka syllabusin e saj. Ato përditësohen vazhdimisht mbi bazën e nevojave dhe zhvillimeve në fushën e së drejtës, mbi bazën e propozimeve të lektorit/titullarit të lëndës dhe në nivel departamenti. Nga të dhënat në dosje dhe vizita në institucion, rezulton se departamenti bën përpjekje për të pasuruar literaturën që u ofronte në syllabuset e lëndëve studentëve të shkencave juridike, përfshirë edhe ata të këtij programi.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 66-Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018, Minutat e vizitës së GVJ-së).</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përmbajtja e programit evidenton vëmendjen ndaj arsimimit dhe përgatitjes së studentëve me një bagazh të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive. Mund të thuhet mund të thuhet gjithsesi me kurrikulën e programit përgjithësisht se mund të arrihet një bazë e vlefshme edukimi për të diplomuarit në fushën e drejtësisë për të vijuar thellimin e studimit në</p>



	<p>programet të ciklit të tretë në fusha të lidhura me të drejtën ndërkombëtare dhe atë penale. (Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor, Minutat e vizitës së GVJ-së).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të fituar kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në të dy profilet. Në tërësi mund të thuhet se programet e profileve synojnë përvetësimin e koncepteve bazë juridike në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare, aftësimin praktik të studentëve dhe teorik të studentëve me zhvillimeve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare si dhe përgatitjen e specialistëve në fushat e ndryshme të jurisprudencës ndërkombëtare në Shqipëri.</p> <p>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 62- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas informacionit të ofruar në Institucion, për përmirësimin e programit Master, Institucioni organizon aktivitete praktike të ndryshme për të vlerësuar kërkesat e pritshmëritë e tregut si dhe mban kontakte me alumni të programeve të tij nëpërmjet klubeve e organizimeve të tyre. Nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të ndryshme dhe komunikimeve të drejtpërsëdrejta me përfaqësues të institucioneve apo takimeve me alumni të programit, vlerësohet nevoja për të shtuar informacion apo pasuruar burimet e tij, etj. (Minutat e vizitës së GVJ-së).</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi kombinon veprimtari të formimit teorik me orët praktike në lëndë të ndryshme, praktikë profesionale në kredite të ndara brenda programit, etj. Mund të thuhet mund të thuhet gjithësesi me kurrikulën e programit përgjithësisht se mund të arrihet një bazë e vlefshme edukimi për të diplomuarit në fushën e drejtësisë për të vijuar thellimin e studimit në programet të ciklit të tretë në fusha të lidhura me të drejtën ndërkombëtare dhe atë penale.</p> <p>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 6- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor).</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


### Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Sic është evidentuar më sipër, për të përmbushur objektivat e programit të studimit, Departamenti ka bërë përpjekje për të afruar personel akademik të kualifikuar në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit. Sidoqftë, balanca në cdo vit akademik anon nga ana e personelit akademik me kohë të pjesshme, megjithëse është gati në raport të balancë. Raporti mes PAE/PAK të anagzhuar në program nga ana e departamentit në vitin 2020-2021 është 40% PAE dhe 60% PAK, ndërsa për vitin akademik 2021-2022 është akademike është afërsisht 45 % PAE dhe 55% PAK.</p> <p>Referuar dokumentit <i>Evidenca 58 – Cilesia e Mësimdhënës për Programin e Studimit</i>, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie si numër fizik për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>22</b> pedagogë gjithsej, ndër të cilët <b>9 PAE</b> nga ku 1 me titull “Prof.Dr.”, 3 me gradën “Dr.”, dhe 5 me “Msc” dhe <b>13 PAK</b> nga ku: 1 me titull “Prof.Dr.”, 1 me titull “Prof.As”, 4 me gradën “Dr.”, dhe 7 me “Msc”;</p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021</b> janë të angazhuar <b>28</b> pedagogë gjithsej, ndër të cilët <b>12 PAE</b> nga ku 1 me titull “Prof.Dr.”, 5 me gradën “Dr.”, dhe 6 me “Msc” dhe <b>16 PAK</b> nga ku: 1 me titull “Prof.Dr.”, 1 me titull “Prof.As”, 5 me gradën “Dr.”, dhe 9 me “Msc”;</p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022</b> janë të angazhuar <b>23</b> pedagogë gjithsej, ndër të cilët <b>10 PAE</b> nga ku 1 me titull “Prof.Dr.”, 5 me gradën “Dr.”, dhe 4 me “Msc” dhe <b>13 PAK</b> nga ku: 1 me titull “Prof.Dr.”, 5 me gradën “Dr.”, dhe 7 me “Msc”. Duke qenë se programi Master Shkencor i përket ciklit të dytë të studimeve, sipas kriterëve ligjore personeli akademik i angazhuar duhet të ketë gradën Dr. të paktën për drejtuesit e lëndëve/moduleve.</p> <p><i>(Evidenca 58 – Evidenca e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit, Evidenca 56- Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	



	<i>Programit, Evidenca nr. 64- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës).</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi varion në kualifikime, ku disa janë edhe me eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies, me tituj dhe grada shkencore, apo edhe eksperiencë në pozicione të ndryshme dhe në sistemin e drejtësisë. <b><u>GVJ sugjeron se në mbulimin e lëndëve të programit, do të ishte e volitshme që pjesa me e madhe e lëndëve të të dy profileve të ketë të paktën në ekip personel akademik të brendshëm për të siguruar një qëndrueshmëri dhe kualifikimin e personelit akademik të brendshëm në një drejtim të caktuar dhe për të qenë gradualisht titullarë lëndësh/modulesh në përputhje me kualifikimin e tyre.</u></b></p> <p><i>Evidenca 58 – Evidenca e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit, Evidenca 56- Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit, Evidenca nr. 64- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës Evidenca nr. 58: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit, Evidenca nr. 59-Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas informacionit të dorëzuar dhe takimeve të GVJ në institucion, për qëllime të praktikës së programit janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me subjekte të ndryshme publike e privatë për të realizuar orët e praktikës profesionale. Departamenti angazhon pedagogë mbikëqyrës për pjesën e orëve të lëndës së praktikës në auditor të cilët janë kryesisht pedagogë efektiv. Gjithashtu, sipas Rregullores së programit studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli. Punimi i diplomës gjithashtu realizohet nën drejtimin e një pedagogu sipas interesit të shprehur nga ana e studentëve dhe përshtatshmërisë së profilit të tij. Udhëheqësit e konsultuar i përkasin personelit që zotëron gradën shkencore “Doktor” dhe Prof. Asoc. Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe po sipas Rregullores, udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë Evidenca nr. 48-Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale, Evidenca nr. 57- Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në</i></p>



	<i>rang Programi/esh studimi, Evidenca nr. 82-Syllabus lënda "Teza", Evidenca nr. 79- Formular i ecurisë së tezës)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Nuk rezulton të ketë anagazhim personeli ndihmës mësimorshkencor pranë programit Master Shkencor në Drejtësi në të 2 profilet. Sidoqoftë, për qëllime të asistencës në lidhje me burime informacioni, përdorimi i sistemit online të bibliotekës, etj. mund të thuhet se gjatë vizitës së GVJ, angazhimi nga ana e personelit të bibliotekës dhe stafit administrativ të institucionit ishte i dukshëm.  (Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 6- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Nga vizita në Institucion, GVJ vlerëson se personeli akademik dhe institucioni kanë në vëmendje përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Personeli i angazhuar në lëndë vlerëson nevojën mbi ndryshimet e mundshme në kuadër të përshtatjes së kurrikulës sipas kërkesave ligjore në fuqi apo përshtatjes sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. Sipas komunikimit me pedagogët e anagzhuar në program ata kanë liria akademike për të bërë ndryshimet e nevojshme duke i përcjellë për miratim në department. Në këtë process përfshirja e profesionistëve të praktikës në mësimdhënie përmbush edhe nevojën për të përcjellë në syllabuse mendimet e profesionistëve të fushës. (Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në	Nga vizita në Institucion dhe diskutimeve me interlokutorët, për përmirësimin e programit të studimit përfshihen edhe studentët në këtë process. Mendimet merren përmes formularëve të vlerësimit periodikë, kontakteve me koordinatorët apo dpd me pedagogët e lëndëve, pyetsorë të ndryshëm që plotësojnë studentët për qëllime të proceseve të vlerësimit të brendshëm, etj. Nga takimi i GVJ-së më studentë të këtij programi, nuk u përcoll ndonjë rast i posacëm duke

36



funksion të përmirësimit të programit të studimit.	u shprehur të kënaqur me programin e studimit. ( <i>Minutat e vizitës së GVJ-së</i> )			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Sipas informacionit të ofruar në Institucion, për përmirësimin e programit Master, Institucioni organizon edhe aktivitete praktike të ndryshme për të vlerësuar kërkesat e pritshmëritë e tregut si dhe mban kontakte me alumni të programeve të tij nëpërmjet klubeve e organizimeve të tyre. Pranë institucionit funksionojnë Zyrat e Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarit që për qëllim, ndër të tjera, afrimin e institucioneve të sektorit privat ose publik me studentët aktualë ose të diplomuar. Nëpërmjet marrëveshjeve me institucione të ndryshme dhe komunikimeve të drejtpërsëdrejta me përfaqësues të institucioneve vlerësohet dhe shpërndahet informacion mbi programin që mundëson edhe marrjen e sugjerimeve mbi të. ( <i>Evidenca nr. 01: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02: Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 83: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës, Minutat e vizitës së GVJ-së</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Nuk lidhet me programin në vlerësim.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.7

#### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në programin e studimit janë përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe specifike të tij. Referuar objektiveve të institucionit në Planet Strategjikë të tij, qëllimi i programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" është: të pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar, për të ndërmarrë kërkime shkencore të vlefshme për specifikën shqiptare e atë ndërkombëtare. Në përbushje të këtyre objektiveve, referuar parashikimeve në Rregulloren e programit Master Shkencor në Drejtësi, respektivisht në profilin e drejtë



	<p>ndërkombëtare dhe e drejtë penale, programet kanë për qëllim formimin akademik dhe përgatitjen e juristëve me një bagazh të gjerë në të drejtën penale dhe atë ndërkombëtare, duke synuar përmbushjen e nevojave të tregut të punës me individë të kualifikuar në fushat respektive. (Evidenca nr. 01- Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 03-Plani Strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023, Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Sic u evidentua më sipër, sipas komunikimit me pedagogët e anagzhuar gjatë takimeve të GVJ në institucion, ata kanë lirinë akademike për të bërë ndryshimet e nevojshme duke i përcjellë për miratim në department. Fakulteti dhe Departamenti me drejtuesit përkatës janë përgjegjësit kryesore për realizimin e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit, ndër të tjera, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin në njësinë bazë, evidenton nevojat për staf të ri akademik, merr pjesë në procesin e përzgjedhjes së kandidatave të stafit akademik, i propozon dekanit të fakultetit anëtarët e komisioneve të provimit të formimit apo edhe të mbrojtjes së diplomës për programet që mbulon njësia bazë e drejtuar prej tij.</p> <p>(Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga takimet me studentët GVJ u informua mbi aktivitete të ndryshme të studentëve me karakter studimor, profesional etj si pjesëmarrje në moot courts, apo përfshirje në komponentë të projekteve të ndryshëm në fazë implementimi nga ana e Departamentit. Gjithashtu GVJ u informua për aktivitete periodike me karakter social, sportiv apo kulturor që nxiten dhe mbështeten nga Institucioni për qëllime të krijimit të komunitetit studentor dhe frymës së bashkëpunimit, toleranës, etj. (Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Të dy drejtimet e programit ngrihen mbi konsiderata të rëndësishme të zhvillimit të njohurive për të shkëmbyer qëndrime, ekspertizë etj në nivel kombëtar dhe rajonal. (Evidenca nr. 04: Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht</p>	<p>Nga takimet e GVJ në institucion, evidentohet se stafit akademik i ofrohen mundësi për trajnime të vazhdueshme p.sh. lidhur me strategjitë e publikimit apo të mësimdhënies, për organizimin e arkivës, për shkruajtjen e projekt-propozimeve etj. GVJ u informua</p>



nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	për anëtarë PAE që kanë përfituar mobilitet apo mbështetje financiare për kërkim shkencor nga të ardhurat e Institucionit. ( <i>Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i> ):			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.8

**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Neni 8 i Statutit të Institucionit dhe neni 5 i Rregullores Themelore përcakton Komisionin e Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe inovacionin si një ndër organet drejtuese të institucionit. Sipas nenit 15 të Rregullores, ky Komision është organi përgjegjës që nxit kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Gjithashtu, anëtarët e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Funkcionet e këtij Komisioni përfshijnë organizimin e veprimtarive kërkimore mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara nga njësitë bazë dhe kryesore si dhe vlerësimin e performancës së punës kërkimore shkencore në të gjitha nivelet, mbështetur në standardet e miratuara nga Senati Akademik në përputhje me standardet kombëtare.</p> <p><i>Evidenca nr. 01-Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër Evidenca nr. 07- Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin.)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore përcakton Zyrën e Kërkimit Shkencor si përgjegjëse për hartimin dhe administrimin e politikave për kërkimin shkencor. Kjo zyrë “synon të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë impaktin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit.” Kjo rregullore përmend grantet kërkimore të cilat janë në dispozicion të personelit të brendshëm dhe të jashtëm dhe akordohen në bazë të meritës së projektit. Udhëzimi për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor ndër të tjera përcakton dhe një</p>



	<p>sistem vlerësimi bazuar në pikë nëpërmjet të cilit mundësohet vlerësimi i stafit akademik në bazë të llojit të publikimit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 02-Rregullorja themelore e KU Bedër Evidenca nr. 07-Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, Evidenca nr. 14-Rregullorja mbi kërkimin shkencor.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Sipas të dhënave nga institucioni, megjithë vështirësitë e krijuara nga pandemia, institucioni ka organizuar disa aktivitete shkencore në fushën e së drejtës.</p> <p><i>(Evidenca nr. 22- Procedura e mbështetjes së pjesmarrjes në konferenca nga KU Beder Evidenca nr. 27: Lista e konferencave shkencore, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi bëhet sipas standardeve të vendosura nga Institucioni në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Gjithashtu, Institucioni ka hartuar dhe përdor udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, ku përfshihen edhe informacion mbi mësimdhënien. Programi ofron një kombinim midis leksioneve dhe seminareve. Pedagogët kanë liri akademike në përcaktimin e përmbajtjes së syllabus-eve në përputhje me objektivat e programit të studimit; gjithashtu edhe për metodën e përshtatshme të mësimdhënies. Siç është përmendur dhe më lart, një nga format e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies është përmes anketave/vlerësimeve të studentëve për pedagogët të cilat zhvillohen në përfundim të lëndës. Format kryesore të mësimdhënies për këtë program studimi janë leksionet dhe seminarat dhe orët praktike. Institucioni ka miratuar “Guidën e Studentit” një dokument orientues lidhur me institucionin, shërbimet e në dispozicion të studentit, zyrat përkatëse, rregullat akademike, çështje administrative dhe të lidhura me programin e studentit (si regjistrimi i lëndëve, metodat e vlerësimit, sezoni i provimeve, diplomimi, procedurat ankimore etj).</p> <p><i>(Evidenca nr. 11- Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve, Evidenca nr. 24-Guida e Stafit, Evidenca nr. 25- Guida e Studentit, Evidenca nr. 39-Syllabuset e lëndëve të programit).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë përmban “rregullat e funksionimit të këtyre programeve dhe të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në veprimtaritë e tyre. Ajo përcakton strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të programeve të studimit të ciklit të dytë, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, raportet ndërmjet tyre, etj.”NJSBC si strukturë e ngritur me qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë në vlerësimet periodike përfshin edhe vlerësimin e pedagogut nepermjet anketimeve të studenteve mbi metodologjitë e mësimdhënies. Po ashtu, departamenti ka ngritur edhe grupin e sigurimit të cilësisë për bashkëpunimin dhe bashkërendimim me strukturat institucionale për garantimin e cilësisë, duke përfshirë këtu edhe monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive mësimdhënëse të tij. Rezultatet e monitorimeve përfshihen në raportin vjetor që behet në fund të çdo</p>




41





	<p>viti ne department si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 09: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 10: Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-së)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Sic u theksua dhe më sipër, studentëve u jepet mundësia për vlerësuar mbi format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetsorëve që realizohen në fund të zhvillimit të cdo semestri, duke ruajtur anonimat. Pyetsorët përfshijnë pyetje mbi pedagogun, metodën e mësimdhënies, nivelin e përgatitjes, literaturën, përmbajtjen e lëndës, etj si dhe për asistencën nga stafi administrativ. Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimin e cilësisë. Në 2 vitet e fundit është marrë mendim edhe për efikasitetin e mësimdhënies online.</p> <p><i>(Evidenca nr. 11- Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve, Evidenca nr. 29- Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët, Evidenca nr. 32-Anketa e posacme e realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Siç u evidentua dhe më sipër, pas përpunimit statistikor dhe cilësor të të dhënave ato shfrytëzohen për vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik. NJSBC informon gjithashtu dekanin dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe stafit akademik në të ardhmen. Në përfundim të këtij procesi, NJSBC harton një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institucionit ose/dhe të programit të studimit, përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. Ky raport i bëhet me dije Senatit Akademik, i cili pasi e merr në shqyrtim, e miraton.</p> <p><i>(Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 09: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 10: Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-së).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Megjithëse nuk u përcoll ndonjë model i vlerësuar si shembull i një praktike të mira, sipas shpjegimeve të marra gjatë vizitës, rezultatet nxjerra përpunohen nga NJSBC-ja, duke vlerësuar nevojën për të zhvilluar më tej aspekte të vecanta të performancës në institucion. Mbi bazën e këtyre gjetjeve NJSBC harton planin e trajnimeve tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë. <i>(Evidenca nr. 33- Plani i trajnimeve të personelit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.2


**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në planin mësimor ngarkesa e lëndëve është e përcaktuar në bazë të numrit të krediteve sipas sistemit ECTS/ orë mësimore në auditor Mësimdhënia kombinon forma të ndryshme të aplikuara si: leksione, seminarë, detyra kursi, orë praktike, etj. Një kredit është 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminarë, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit). Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua edhe për organizimin e leksioneve të hapura, sidomos me lektorë të huaj, apo të personaliteteve në fushën e drejtësisë në kuadër të zhvillimeve të rëndësishme si reforma në drejtësi etj.</p> <p><i>(Evidenca nr. 61- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E), Evidenca nr. 6- Plani mësimor sipas modelit, Evidenca nr. 63- Ndryshimet në planin mësimor, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Në takimin me një grup pedagogësh gjatë vizitës në Institucion, GVJ vlerësoi frymë pozitive dhe bashkëpunuese në lidhje me rregullat e institucionit, mbi metodat e mundësitë alternative të mësimdhënies e mësimnxënies etj. Pedagogët kanë qenë vecanërisht të gatshëm dhe bashkëpunues për metodat e reja të mësimdhënies përgjatë 2 viteve të fundit ku mësimdhënia është realizuar online, duke pasur fleksibilitetin e nevojshëm për të marrë feedback nga studentës dhe përmirësuar procesin. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave</p>	<p>Sipas informacionit të marrë në takimin me pedagogët në vizitën në institucion mbështet dhe nxit personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike apo përdorimin e metodave të</p>



<p>didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>shumëllojshme dhe fleksible në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe specifikat e tij. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Drejtësisë përbëhet nga anëtarë me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme, specialistë të fushës juridike, me tituj e grada shkencore, magjistratë apo edhe staf me diplomën ‘Master i Shkencave’. Personeli akademik bën përpjekje për të rritur nivelin e tij të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve me rëndësi është edhe kërkimi shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Departamenti i Drejtësisë bashkëpunon dhe me Zyrën e Kërkimit Shkencor që bashkërendojë punën me departamentin për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe kontribuon në përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare për zhvillimin e aftësive mësimdhënëse e kërkuese shkencore.</p> <p><i>(Evidenca 58 – Evidenca e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit, Evidenca 56- Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit, Evidenca nr. 64- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës Evidenca nr. 58: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit, Evidenca nr. 59-Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sic u evidentua më sipër nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga studentët, më anë të pyetësorëve apo kërkesave të studentëve mbi metodat e mësimdhënies nga përfaqësimi i tyre në organet e ndryshme të institucionit, mund të thuhet se institucioni vlerëson dhe përpiqet të adresojë kërkesat e tyre në lidhje me sa më sipër.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Sipas informacionit të marrë në takimin me pedagogët dhe studentët në vizitën në institucion, mësimdhënia përfshin gjerësisht format interaktive, trajtimin e kazuseve, simulimin e rasteve që lidhen me praktikën gjyqësore dhe jursiprudencën vendase apo ndërkombëtare, etj. <i>(Evidenca 3.8 – Raporti Vjetor DSHJ 19-20; Evidenca 1.5 - Rregullore; Minutat e vizitës).</i></p>




<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Sipas informacionit të marrë në takimin me pedagogët dhe studentët në vizitën në institucion, metodat e mësimdhënies synojnë nxitjen e studentit për të dhënë mendim të pavarur apo qëndrim reflektiv për sidomos për raste të ndjeshme të praktikës me qëllim nxitjen e arsyetimit dhe të menduarit kritik. Në takim u përcoll vlerësim reciprok, mbështetje nga ana e studentëve, pa evidentuar ndonjë problematikë. <i>(Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.3</b> Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerësoi se sallat në godinën e re të Institucionit janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor për studentët e këtij programi studimi. Për arsye të situatës, në 2 vitet e fundit akademike procesi mësimor është zhvilluar online. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerësoi se sallat në godinën e re të Institucionit janë sipas kushteve bashkëkohore të ngritura si salla e klasa për zhvillim procesesh mësimore, me laboratore për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe akademik. Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si: videoprojektor, etj., për realizimin e mësimdhënies të metoda e teknologji bashkëkohore. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Nga vëzhgimi i ambienteve gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerësoi se sallat në godinën e re të Institucionit mund të thuhet se zyrat e personelit akademik janë në kushte të përshtatshme infrastrukturore. Në funksion të studentëve është laborator i informatikës, i cili mundëson aksesin nëpërmjet account personal të pedagogëve dhe studenëtëve në burime informacioni online, bibliotekë, etj.</p> <p>Në kushtet e zhvillimit të mësimin online, stafi i IT-së së universitetit ka garantuar akses të plotë të personelit akademik dhe</p>




45





	<p>studentëve për të zhvilluar mësimin në mënyrë online. Nga takimi me studentë dhe pedagogë të këtij programi, rezultoi se këto sisteme/platforma kanë funksionuar në mënyrë efikase. (<i>Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Nga vëzhgimi i syllabuseve të lëndëve por edhe i titujve të bibliotekës fizike dhe online të Institucionit mund të thuhet se ka një përpjekje të mirë për të përfshirë në literaturë informacionin e nevojshëm për qëllimet e programit të lëndëve. Literatura e rekomanduar është e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde. Ka lëndë që nuk kanë një literaturë të vecantë sic janë lëndët e Tema specifike në Drejtësi, për të cilat literatura përgatitet nga ana e lektorit të lëndës sipas temave të përfshira. Në përgjithësi, literatura e ofruar në bibliotekë është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat më themelore të studimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>Megjithatë, fondi i bibliotekës duhet përditësuar si dhe institucioni duhet të sigurojë që materialet e detyrueshme në lëndë të caktuara të gjenden në bibliotekë. Institucioni ka hartuar “Planin Strategjik Institucional” për vitin 2018-2023 i cili përmban, ndër të tjera, si pjesë të objektivave strategjike dhe përditësimin e bibliotekës “sipas fushave përkatëse, si dhe stimulimi(n) i(e) studentëve në përdorimin e bibliotekës online.” Institucioni ka bibliotekën e tij, e aksesueshme nga ambientet fizike ose online. Biblioteka zotëron fondin e saj fizik me botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti, sic ishte dhe informacioni më i fundit i marrë gjatë vizitës në Institucion. Ofrohet mundësia edhe për akses të studentëve në biblioteka online, pa pagesë.</i></p> <p><i>(Evidenca nr. 40-Marrëveshja për akses në JSTOR, Evidenca nr. 68- Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë, Evidenca nr. 69-Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj, Lista e titujve që kane hyre vitet e fundit)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. në</p>	<p>Literatura që shoqëron lëndët e programit sipas syllabuseve përgjithësisht gjendet në Bibliotekën e institucionit e cila përmban titujt kryesorë të së drejtës kombëtarë, ndërkombëtare dhe europiane. Nga vizita në institucion mund të thuhet se salla e bibliotekës së fakultetit, disponon një numër relativisht të vogël tavolinash, shoqëruar me kompjutera, me objektivin për t’u shtrirë më gjerë në hapësirë. Biblioteka e fakultetit shërben njëkohësisht edhe si sallë interneti. Ajo përmban literaturë profesionale juridike kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze. Interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, por edhe të stafit</p>



	<p>akademik. Sipas informacionit në faqen e internetit të institucionit, biblioteka qëndron e hapur çdo ditë për studentët në këto orare: 08.00 - 12.00 dhe nga 01.00 - 17.00. Me kërkesë të GVJ, institucioni vuri në dispozicion listën e titujve në gjendje në bibliotekë lidhur me programin e Drejtësisë. Nga shqyrtimi i listës së librave si dhe nga kërkimi në faqen e internetit të bibliotekës (<a href="http://library.beder.edu.al/">http://library.beder.edu.al/</a>), mund të thuhet se studentët dhe stafit akademik kanë mundësi të aksesojnë titujt kryesorë të së drejtës kombëtare, ndërkombëtare dhe europiane. (Evidenca nr. 18- Udhëzimi mbi funksionimin e bibliotekës, Lista e titujve që kanë hyre vitet e fundit.)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies personeli akademik dhe studentët aksesojnë Jstore, pa pagesë, si në ambientet e institucionit ashtu edhe jashtë tij. Aksesit sigurohet nëpërmjet abonimit si dhe mund të arrihet lehtë nëpërmjet shërbimit të internetit <i>ëireless</i> në të gjithë godinën.</p> <p>(Evidenca nr. 40-Marrëveshja për akses në JSTOR, vizita në Institucion e GVJ.)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Siç është përmendur, në funksion të studentëve është edhe laboratorit i informatikës. Kjo infrastrukturë i ndihmon studentët për përgatitjen e eseve/detyrave në lëndët e këtij programi studimi si dhe për temat e diplomave. (Vizita në Institucion e GVJ.)</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Sic është evidentuar më sipër, studentët e pedagogët kanë akses në platformë online e cila ka qenë vecanërisht e përdorshme gjatë 2 viteve të fundit akademike. Studentët e vlerësuan pozitivisht përdorimin e platformës për qëllimet e procesit mësimdhënës.</p> <p>(Evidenca nr. 69- Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj, Vizita në Institucion e GVJ.)</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se si personeli akademik ashtu dhe studentët mbështeten gjerësisht në përdorimin e komunikimit elektronik dhe platformës online si një mënyrë efektive, që mundëson komunikim më të shpejtë mes tyre. Po ashtu, studentët dhe personeli akademik dhe administrativ kanë edhe adresat e tyre të e-mail me domain të universitetit duke lehtësuar komunikimin mes tyre. Po ashtu, përmes këtyre forumeve online, studentët mund të jepen informacion në lidhje me jetën studentore, oraret e kurseve, pedagogët, leksionet/materiale mësimore, administratën, etj.</p>




	<i>(Evidenca nr. 69- Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj. Vizita në Institucion e GVJ.)</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	<p>Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Tema e diplomës ka karakter teoriko-aplikativ dhe studentit drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili ka dhënë miratimin e tij</p> <p>Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, përmes sistemit të tutorimit, duke respektuar detyrimet për një temë diplome të nivelit Master. <i>(Evidenca nr. 09 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 79- Formular i ecurisë së tezës, Evidenca nr. 50- Vendim për ngritjen e jurive të tezave master)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë është ngritur dhe vepron Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit (Komisioni) si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Njësia). Në bazë të nenit 8 të Statutit, Komisioni dhe Njësia janë organe drejtuese të institucionit. Në bazë të nenit 12 të Statutit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të pare propozon komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Në bazë të nenit 14 të Rregullores Themelore “Komisioni i përhershëm për garantimin e cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit ngrihet me vendim të Senatit Akademik. Anëtarët e njësive miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit”. Njësia është përgjegjëse për mbështetjen e Komisionit në hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, për vlerësimin në mënyrë periodike të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, për vlerësimin e ecurisë së punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit, për ndjekjen e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, për organizimin e pyetësorit studentor në</p>








	fund të çdo semestri, si dhe për raportimin para Senatit Akademik lidhur me rezultatet dhe propozimet përkatëse. ( <i>Evidenca nr. 10- Rregullore për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti i Drejtësisë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti harton raportin vjetor të vetëvlerësimit të programit të studimit sipas modelit të miratuar për këtë qëllim. Ky raport, kopje e të cilit i jepet edhe departamentit, i shërben departamentit për të parë praktikën e mira dhe pikat e dobëta të cilat duhet të adresohen dhe kërkojnë ndërmarrjen e hapave konkrete me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij programi, të mësimdhënies dhe mësimnxënies ( <i>Evidenca 6.4 - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë – Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së</i> )
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Strukturat drejtuese të Institucionit, njësia kryesore dhe njësia bazë, mbështesin metodat e reja dhe inovative në mësimdhënie. Sic u evidentua dhe më sipër pedagogët e këtij programi përdornin metoda mësimdhënie sa më atraktive për studentët me forma interaktive, simulimin e rasteve që lidhen me praktikën gjyqësore, etj. ( <i>Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i> )
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Personeli akademik bën përpjekje për të rritur nivelin e tij të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve me rëndësi është edhe kërkimi shkencor për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Mbeshtetja nga universiteti për kërkim shkencor, rregjistrim në programin e dokt në universitetin e ferrares, mora leje nga institucioni edhe për kërkimin shkencor në graz duke pasur dhe pjesën financiare të paguar. Kërkimi shkencor është i mbështetur nga departamenti, mbahen në marrëdhënie financiare gjatë kohës që janë me studime ose kërkime jashtë  Mbeshtetja behet edhe ndaj pedagogeve të jashtëm në drejtim të mbështetjes financiare. Institucioni boton revistën periodike “ <i>Beder Journal of Humanities</i> ”, ku ndër të tjera botohen dhe artikuj e punime në fushën e së drejtës. Këto punime mund të aksesohen online: <a href="http://bjh.beder.edu.al/">http://bjh.beder.edu.al/</a> . Institucioni synon t’i japë në rradhë të parë mundësi stafit të institucionit për të botuar, por edhe studiuesve të tjerë nga institucione të tjera. Qëllimi i kësaj reviste është nxitja e debatit shkencor si dhe publikimi/promovimi i punës shkencore të stafit akademik. Po ashtu, Departamenti i Drejtësisë bashkëpunon dhe me Qendrën Kërkimore e Shkencore, Zyrën e Projeketeve për aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte institucionale apo ndër-universitare. ( <i>Evidenca nr. 22- Procedura e mbështetjes së pjesëmarrjes në</i>



	<i>konferenca nga KU Beder, Evidenca nr. 33- Plani i trajnimeve të personelit, Evidenca nr. 45- Plani i Aktiviteteve, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni organizon trajnime të herëpashershme në bashkëpunim me departamentin dhe strukturat e tjera, përmes trajnimeve të ndryshme tematike, tryezave të rrumbullakta, leksioneve të hapura etj me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja nga ana e stafit akademik të departamentit. si psh.  <i>(Evidenca nr. 33- Plani i trajnimeve të personelit, Evidenca nr. 45- Plani i Aktiviteteve, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik në këtë program studimi është përgjegjës për zbatimin e tij dhe cilësinë e mësimdhënies. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen, azhornimin e syllabuseve dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të parashikuar në të, si pjesë e detyrimeve të tij akademike, metodologjinë e mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës, etj.  <i>(Evidenca nr. 46- Model Kontrate, Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit Evidenca nr. 66-Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018).</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik bën përpjekje të aplikojë metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit që mundësohet edhe nga institucioni. Kjo lehtëson mësimdhënien në lëndë të caktuara dhe sipas specifikave të temave, e bën mësimin më interaktiv dhe më interesant për studentët. Këto elementë të mësimdhënies bëhen pjesë e analizës periodike të departamentit, si dhe pjesë e informacioneve që përgatit dhe raporton njësia (departamenti) apo edhe pjesë e raporteve institucionale. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion, Evidenca nr. 23- Model Raporti Vjetor).</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Siç u përmend edhe më parë, në kuadër të bashkëpunimeve me partnerë të ndryshëm vendas apo të huaj, në këtë program studimi ka dhe angazhim të lektorëve të ftuar, vendas apo të huaj, me qëllim rritjen e shkëmbimit, forcimin e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion, njoftimet në faqen e Institucionit për leksione të hapura)</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>








**Standardi III.5**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave e të kompetencave profesionale të programit. Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është dinamik dhe përbëhet nga disa komponentë. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimave me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikave mësimore dhe gjyqeve simuluese si dhe tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin. Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e kontrollit të dijeve/vlerësimit në lëndë. Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimin në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.</p> <p><i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të semestrit, studentëve iu vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që ndjekin. Çdo pedagog në fillim të lëndës pedagogu i njeh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusin: emërtimi dhe kreditet e lëndës, pedagogun/pedagogët e lëndës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar.</p> <p>Informacioni që marrin studentët nga broshurat informative, Java e orientimit, kontakti me pedagogët e departamentit gjatë zhvillimit të lëndëve, syllabuset që u jepën studentëve për çdo lëndë, si dhe</p>





	Rregullorja e programit që ata ndjekin parashikon informacionin e duhur për vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve <i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Evidenca nr. 25: Guida e Studentit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është dinamik dhe përbëhet nga disa komponentë: testime me shkrim e me gojë, detyra kursi, prezantimeve, praktikave profesionale dhe gjyqeve imituese si dhe tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit. Përgjithësisht në të gjitha lëndët sipas komunikimit me pedagogët e programit vlen parimi i kontrollit të vazhdueshëm të njohurive. <i>(Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Evidenca nr. 25: Guida e Studentit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Siç u përmend më sipër, testimi dhe vlerësimi në lëndë, është i vazhduar dhe përbëhet nga disa komponentë, e realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke dhënë në fund rezultatin/notën përfundimtare. Shkalla e përvetësimit të dijeve/vlerësimi bëhet me sistemin e pikëve nga 0-100 pikë (në përqindje nga 0-100%) dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me shkronja nga F në A.  <i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sipas të dhënave institucionale por dhe nga vizita në institucion, rezulton se vlerësimi i provimeve bëhet i sekretuar (bar code) për të garantuar objektivitetin në vlerësim dhe për të rritur transparencën. Në kushtet e mësimit online, provimet janë zhvilluar përmes platformës elektronike. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të	Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentëve. Kur lënda ka edhe asistent, vlerësimi



<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>bëhet nga të dy pedagogët që angazhohen në lëndë (<i>Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Përsa i përket kontrollit të njohurive, sipas parashikimeve në rregulloret e brendshme, provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Në kushtet aktuale, është aplikuar testimi online, që ka avantazh pasi garanton transparencë dhe lehtësi në vlerësim. (<i>Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në kontaktin e marrë me student e pedagogë, GVJ u informua se vlerësimi i njohurive shoqërohet me feedback nga ana e pedagogëve për të dhënë mundësinë studentëve për t'u informuar si dhe për ta ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. Në rast se studenti pretendon nese, kanë bërë rishikim të vlerësimit dhe nëse ka qenë rasti edhe ka ndryshuar ky vlerësim. Ndërsa ngritje komisioni ankimimi, deri tani nuk ka pasur, sipas pedagogëve të pranishëm gjatë vizitës. Gjithashtu edhe Rregullorja bën përcaktimin në lidhje me korigjimin e tezave të provimeve, vlerësimin dhe rivlerësimin e tyre. (<i>Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Rregulloret institucionale dhe rregullorja e programit të studimit parashikon rregulla për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës. Gjithashtu edhe rregulloret e institucionit parashikojnë ndër të tjera detyrimin e tyre për të respektuar etikën gjatë procesit mësimor, apo në tërësi të rregullave të proceseve akademike dhe atyre të kërkimit shkencor. (<i>Evidenca nr. 25- Guida e Studentit, Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e programit të studimit. Pedagogu vlerëson me pikë çdo komponent të tezës së provimit. Tezat janë të sekretuara me bar code, kështu që japin garanci për objektivitet në vlerësim. Rezultate dorëzohen në sekretari dhe u bëhen me dije studentëve, ose mund të merren përmes aksesit në sekretarinë online. Gjatë dy viteve të fundit akademike, zhvillimi i</p>



	<p>provimeve në platformën online ka krijuar lehtësira në drejtim të informimit të shpejtë dhe efikas të rezultateve të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Evidenca nr. 16: Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim për vlerësimin e bërë, kur nuk është dakord me të. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë dhe Rregullorja e programit të studimit si dhe Guida e studentit parashikojnë hapat në lidhje me kontrollin e dijeve, të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe pedagogëve përgjegjës.</p> <p><i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 25- Guida e Studentit Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Sic është evidencuar më sipër, procesi i kontestimit është i rregulluar në rregulloret më lart. Nga takimet e GVJ në institucion me studentët, në cdo rast kontestimi kanë pasur mundësi të depozitojnë kërkesë në sekretari e më pas të diskutojnë me titullarin e lëndës. Nuk rezulton të ketë pasur rastet të ngritjes së një komision me vendim të Dekanit për të rivlerësuar provimin, duke u zgjidhur cdo mosmarrëveshje në nivelin e titullarit të lëndës.</p> <p><i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 25- Guida e Studentit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi III.7</b></p> <p><b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive,</p>	<p>Ky program studimi synon t'i përgjigjet nevojave të tregut për specialistë në fushën e së drejtës penale dhe asaj ndërkombëtare nëpërmjet edukimit dhe pajisjes së studentëve me njohuri të</p>



<p>të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>avancuara të karakterit shkencor në këto dy degë të rëndësishme të së drejtës. Në lidhje me këtë objektiv, programi synon të zhvillojë tek studentët aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në sferën profesionale.</p> <p><i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61-Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit është pjesë e programeve të ciklit të dytë të studimeve që ofron Departamenti i Drejtësisë, dhe synon të zhvillojë aftësi në fushën e së drejtës (shkenca humane sociale). Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thëllon njohuritë dhe kapacitetet e studentëve në fushën e të drejtës penale dhe të drejtës ndërkombëtare.</p> <p><i>(Evidenca 09- Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 61-Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në syllabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në lëndë. Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit, në gjithë treguesit që ka ky vlerësim. Metoda e vlerësimit është ajo e vazhdueshme, gjatë gjithë semestrit ku zhvillohet lënda, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë dhe/apo shkrim. <i>(Evidenca nr. 39- Syllabuset e lëndëve të programit, Evidenca nr. 61-Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik të programit GVJ u informua se pothuasje të gjithë titullarët e lëndëve bëjnë një përmbledhje për efekt orientimi dhe përsëritje të koncepteve/çështjeve kryesore të trajtuara, si dhe për të orientuar studentët për provimin përfundimtar të lëndës. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Sic u theksua më lart, GVJ u informua që personel akademik efektiv por sidomos i ftuar realizon periodikisht leksione të hapura, ëorkshops etj. Një nga aktivitetet më të afërta me vizitën e GVJ ishte ëorkshop i lektorese Valentina Ndou, nga Universiteti i Salentos në</p>



<p>teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Itali, me temë “<i>Innovative Approaches to teaching: Entrepreneurship Education</i>”.</p> <p>(Evidenca Minutat e takimeve të GVJ në Institucion si dhe informacion online në Kolegji Universitar Bedër (<a href="http://beder.edu.al">beder.edu.al</a>)).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Sic u theksua më lart, GVJ u informua se mësimdhënia në këtë program studimi, kombinon formimin teorik me përvojën praktike që vjen sidomos nga lektorët që janë njëkohësisht profesionistë në institucione të rëndësishme të lidhura me fushën e drejtësisë penale apo të drejtës ndërkombëtare. Programi përfshin tashmë dhe orë praktike të cilat i japin mundësi studentëve ti zhvillojnë më tej këto aftësi. Praktika zhvillohet në një nga institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi dhe koordinohet e mbikqyret nga një pedagog i departamentit.</p> <p>(Evidenca nr. 61: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese, Evidenca nr. 63: Ndryshimet në planin mësimor, Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 20- Procedura mbi praktikën profesionale).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik të programit GVJ u informua se metodat e mësimdhënies përfshijnë edhe punë në grup të studentëve, për të angazhuar studentët në një debat interaktiv dhe angazhues midis tyre si dhe për të nxitur punën në skuadër midis tyre. (Minutat e takimeve të GVJ në Institucion).</p>
<p><b>-Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik të programit GVJ konstatoi se stafi akademik mbështet studentët për të promovuar idetë dhe mendimin e tyre, për të marrë pjesë në aktivitete ekstrakurikulare apo në programe mobiliteti, në konferenca apo seminare studentore. Për këtë qëllim, stafi i departamentit mbështet, asiston/drejton studentët në përgatitjen e tyre për gjyqe simuluese (moot court) të cilat janë të shumta, apo pjesëmarrje me punime në conference shkencore të organizuara nga ana e insitucionit, apo botime në revistën shkencore të tij.</p> <p>(Evidenca nr. 49- Procesverbal mbledhje departamenti, ku eshte trajtuar nje temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent perfaqesues të studentëve, Evidenca nr. 74- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimet e zhvilluara me studentët dhe stafin akademik të programit GVJ, mund të thuhet se institucioni dhe mbështet studentët zhvillimin e ideve inovative, studime të</p>



e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. Studentët drejtohen nga personeli akademik në gjyqe simuluese (moot court), pjesëmarrje me punime në conference shkencore të organizuara nga ana e institucionit, apo botime në revistën shkencore të tij në “Beder Journal of Humanities”.</p> <p><i>(Evidenca nr. 74- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion, dhe informacion në <a href="http://bjh.beder.edu.al/">http://bjh.beder.edu.al/</a>).</i></p>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe sipas dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton se institucioni ka bërë përpjekje për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si pjesë e programit të mobilitetit studentor Erasmus +. Institucioni rezulton gjithashtu të ketë marrëveshje bashkëpunimi me Universitete publike e jo publike të rajonit e më gjerë në të cilat përfshihen shkëmbime ekspertize në fushat e përbashkëta të studimit për të lehtësuar dhe mundësuar edhe mobilitet. Sipas informacionit të depozituar nga institucioni, nuk ka raste të mobilitetit të studentëve të këtij programi në universitete jashtë vendit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 34- Marrëveshje mobiliteti me programin Erasmus +, Evidenca nr. 74- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Ky program studimi mbyllet me mbrojtjen e diplomës para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim. Komisioni ngrihet nga departamenti dhe miratohet nga dekani. Në përbërje të tij janë 3-5 pedagogë. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës në këtë cikël studimi, institucioni ka përgatitur edhe një manual për punimin e diplomës Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi.



	<i>(Evidenca nr. 09 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 79- Formular i ecurisë së tezës, Evidenca nr. 50- Vendim për ngritjen e jurive të tezave master)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Departamenti ka vënë në dispozicion të studentëve për hartimin e punimit të diplomës dhe zhvillon orë të hapura për t'i orientuar studentët në lidhje me rregullat, udhëzimet për realizimin e punimit të diplomës. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seanca metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur për të asistuar studentët, me udhëzimet e nevojshme për përgatitjen e temës së diplomës. <i>(Evidenca nr. 09 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 79- Formular i ecurisë së tezës, Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar RVB punimi i detyrueshëm i diplomës nga ana e studentit tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, dhe vendoset nga ana e organeve kompetente e njësisë përkatëse. Punimi i tezës përfshihet si lëndëq e semestrit të dytë në këtë program studimi.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv por edhe me kontratë, të profilizuar në fusha të caktuara të së drejtës private. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Propozimi i temave bëhet në departament duke plotësuar nje formular ku propozohet edhe udhëheqesi. Ka një paqartësi mbi rolin e dy Koordinatorëve, Koordinatori i Programeve Master që koordinon pikërisht shpërndarjen e formulareve dhe përpunimin e tyre, dhe Koordinatori i programit nën vlerësim që është përgjegjës për anen formale te temave/tezave të diplomës. Raporti i punës midis të dyve dhe raporti me departamentin duhet qartësuar/thjeshtuar.  Mentorimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, përmes sistemit të tutorimit, sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim në rregulloren e lidhur me përgatitjen e temës së diplomës.  <i>Evidenca nr. 02- Rregullorja themelore e KU Bedër, Evidenca nr. 05- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 43- Vendim i këshillit të departamentit për caktimin e koordinatorit të programit).</i>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për përgatitjen e temës së diplomës, laboratorit i informatikës mund të përdoret si nga studentët ashtu edhe nga stafi i departamentit të shkencave juridike p.sh për hedhjen e të dhënave tabelare, grafike dhe të analizës statistikore, etj. <i>(Minutat e takimeve të GVJ në Institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës mentorojnë studentin gjatë periudhës për përgatitjen e saj. Udhëheqësi orienton studentin në lidhje me përgatitjen e temës me detyra të posaçme në drejtim të integritetit të punimit shkencor. Në përfundim të saj, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij për temën duke e firmosur temën e diplomës që studentit do mbrojë para komisionit në departament. Gjithashtu ai bën vlerësimin e tij sipas formatit të miratuar për këtë qëllim që paraqitet para komisionit të diplomës.</p> <p><i>(Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur nga departamenti dhe vlerësohet me gërmë sipas skemës A-F.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të këtij program studimeve, pasi student ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ai pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga MASR. Në dokumentacionin e paraqitur, është edhe modeli i diplomës që lëshohet për këtë program studimi si dhe suplementin e saj.</p> <p><i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimeve, me kërkesën e studentit, atij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Sipas kuadrit ligjor në fuqi, me diplomimin, studentit pajiset me diplomën përkatëse të ciklit të dytë të studimeve shoqëruar me suplementin e saj. <i>(Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Evidencë shitesë Forma e Diplomës Profili E Drejtë Ndërkombëtare; Forma e Diplomës Profili E Drejtë Penale)</i></p>




<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Gjatë vizitës në institucion dhe sipas dokumentacionit të dorëzuar, GVJ u informua se institucioni mban kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Periudha e ruajtjes është e pacaktuar në rregulloren e programit të studimit.  <i>(Evidenca nr. 04- Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare, Evidenca nr. 09-Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Referuar akteve të vënë në dispozicion, vërehet se institucioni zotëron të dhëna të hollësishme sa i përket numrit të anëtarëve të personelit akademik si dhe të gradave e titujve që këta të fundit zotërojnë, përmbledhje të jetëshkrimeve, etj. <i>(Evidenca 58; Evidenca 52)</i> . Të dhënat janë të administruara për personelin akademik si dhe për atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ <i>(Evidenca 54)</i> . Të dhënat janë mbajtur në mënyrë të detajuar lidhur me angazhimin e tyre çdo semestër dhe vit akademik <i>(Evidenca 59; Evidenca 23, f. 32)</i> .  Institucioni, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm, ka përcaktuar dokumentet që duhet të përmbajë dosja e secilit pjesëtar të personelit akademik dhe administrativ dhe që duhet të administrohen nga zyra e burimeve njerëzore <i>(Evidenca 51)</i> . Gjatë vizitës në institucion u panë në zyrën e burimeve



	njerëzore, sipas përzgjedhjes rastësore, dosje personale të personelit akademik si me kohë të plotë ashtu dhe të pjesshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tyre rezultoi që të dhënat e administruara ishin të plota dhe përfshinin kopje origjinale si dhe të njësuara me origjinalin të: jetëshkrimit, dokumentit të identifikimit, diplomën universitare dhe të listës së notave, diploma dhe dokumente të tjerë që vërtetojnë gradat dhe titujt e fituar, kualifikimet e ndryshme, librezën e punës dhe atë shëndetësore e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, etj. ( <i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Rekrutimi i personelit akademik kryhet nga institucioni në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 80/2015; kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik specifikohen në aktet e brendshme të universitetit. ( <i>Evidenca 1, neni 61; Evidenca 2, nenet 26, 27</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	KUB ka përcaktuar procedura dhe kriteret të posaçme për rekrutimin e personelit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të funksionimit të tij. ( <i>Evidenca 19; Evidenca shtesë "Procedurë rekrutimi të stafit akademik me kohë të pjesshme"</i> ). Sipas nevojave të institucionit, kriteret dhe procedurat bëhen publike nga Zyra e Burimeve Njerëzore nëpërmjet shpalljes pranë Zyrës së Punës si dhe nëpërmjet njoftimit në faqen elektronike të institucionit, për Fakultetin ku është përfshirë ky program studimi ( <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/vende-te-lira-pune-13/411/656">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/vende-te-lira-pune-13/411/656</a> ).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Institucioni ka përcaktuar në mënyrë të qartë hapat që ndiqen në procesin e rekrutimit të stafit akademik, përmes procedurave transparente. Procesi i rekrutimit fillon nga përcaktimi i nevojave që ka njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë), të cilat më pas i përcillen për miratim dhe shqyrtim njësisë kryesore. Dekani i fakultetit ia përcjell në vijim kërkesat rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit. Kërkesa e miratuar i dërgohet për ndjekje zyrës së burimeve njerëzore, e cila bën shpalljen e vendit vakant në faqjen elektronike të IAL si dhe pranë Zyrës së Punës. Të interesuarit dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në zyrën e burimeve njerëzore, e cila bën përzgjedhjen mbi kriteret formale; dosjet që i plotësojnë kriteret formale, i kalohen komisionit <i>ad hoc</i> . Vlerësimi i dosjes së aplikimit realizohet nga komisioni i përbërë prej dekanit të fakultetit, përgjegjësit të njësisë bazë dhe një anëtar të personelit akademik të njësisë bazë. Komisioni bën renditjen e kandidatave dhe ia propozon rektorit për miratim, bashkë me dokumentacionin e nevojshëm. Vendimi i rektorit i kalon më pas zyrës së burimeve njerëzore dhe asaj të





	<p>financës si dhe për dijeni fakultetit e njësisë bazë. Pas plotësimit të të dhënave individuale nga kandidati fitues, zyra e burimeve njerëzore përgatit letrën e emërimit, e cila nënshkruhet nga rektori. Marrëdhënia formalizohet përmes kontratës së punës.</p> <p>(Evidenca 1, neni 61; Evidenca 2, neni 26; Evidenca 19; Evidenca 35); (Evidenca 2, neni 27; Evidenca 46)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nak përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni është angazhuar në aktet e brendshme të tij për mbështetjen dhe aftësimin e personelit akademik (Evidenca 1, nenet 4/1 dhe 58; Evidenca 2, neni 25/1). GVJ ka konstatuar gjatë vizitës në institucion se godina ku realizohet mësimdhënia teorike për këtë program studimi, ka klasa të pajisura me mjetet e dhura audio-vizive, salla të përshtatshme konferencash, të cilat lehtësojnë punën e personelit akademik. Mjediset në dispozicion të stafit drejtues dhe atij akademik, për Qendrën Kërkimore e Shkencore, për personelin administrativ si dhe për sekretarinë mësimore, janë të përshtatshëm dhe me sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së secilit (Evidenca 68, tabela 16). Godina ka shërbim interneti <i>wifi</i>, të hapur për përdorim nga studentët dhe personeli akademik e administrativ i institucionit. Në mbështetje të stafit dhe studentëve funksionojnë shërbimi i fotokopjeve, printimit, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni është angazhuar në vijimësi me qëllim nxitjen profesionale të personelit, gjë e cila shprehet në aktet e tij të brendshme, ku vihet theksi në krijimin e mundësive për të zhvilluar aftësitë e personelit akademik dhe administrativ dhe fuqizimin e kërkimit shkencor (Evidenca 1, neni 4/1, 2 dhe nenet 86 e 87; Evidenca 3, pika G). Praktikisht, institucioni zbaton plane konkrete që kanë të bëjnë me trajnimet e nevojshme për personelin, gjë e cila referohet dhe në faqen 51 të RVB. E përfshirë në këtë proces është zyra e burimeve njerëzore, e cila mbledh nga personeli akademik dhe administrativ, temat që ata i çmojnë të nevojshme për t'u trajtuar në këto veprimtari (Evidenca 33). Gjithashtu, institucioni mundëson kërkimin shkencor të personelit nëpërmjet financimit, krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, mobilitetin, etj. (Evidenca 3, pika B). Për nxitjen</p>




	<p>e stafit akademik në këtë drejtim është parashikuar një buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime (<i>Evidenca 14, neni 14</i>). Gjatë vizitës në institucion u konfirmua ky fakt, zbatuar në praktikë përmes vendimmarrjes së rektoratit dhe dokumentacionit përkatës që vërteton mbështetjen e personelit akademik (<i>Evidenca 22; Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Nga aktet vërehet se KUB nxit po ashtu pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të tilla si konferenca, projekte, seminare, etj. (<i>Evidenca 27; Evidenca 34</i>). Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19, veprimtaritë e këtij lloji janë zhvilluar nëpërmjet platformave online (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet që KUB ka marrë masa në vijimësi për të siguruar trajnimin dhe kualifikimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor. Trajnimet dhe programet janë në harmoni me objektivat që ka marrë përsipër institucioni (<i>Evidenca 3, pika B; Evidenca 23, pika B; Evidenca 84</i>) dhe janë realizuar me trajnues vendas dhe të huaj (<i>Evidenca 33</i>).</p> <p><i>GVJ gjen me vend të evidentojë nevojën për shtimin e marrëveshjeve me IAL të huaja, të cilat do të ndihmonin kualifikimin e mëtjshëm profesional të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor, sidomos në fushën e studimit të këtij programi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Institucioni tregon si në pikëpamje formale, ashtu dhe në atë të zbatueshmërisë, se angazhohet në të gjithë drejtimet për të siguruar përmbushjen e plotë të detyrave nga burimet njerëzore që disponon, me qëllim arritjen e objektivave në kuadër të programit të integruar të studimeve. Detyrat e secilit anëtar, sipas stafeve përkatës, janë të mirëpërcaktuar në aktet e universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat që ky i fundit synon të realizojë (<i>Evidenca 24</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të</p>	<p>KUB disponon infrastrukturën e përshtatshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse të</p>



<p>përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>tij (<i>Evidenca 68</i>). Mësimdhënia për programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Drejtësisë realizohet në një godinë të marrë me qira, e cila zotëron një hapësirë të konsiderueshme shfrytëzimi. Vlerësimi është kryer në ambientet në fjalë, ku u zhvillua vizita nga GVJ si dhe ku zhvillohet programi i studimeve, objekt vlerësimi. GVJ konstaton një sipërfaqe të mjaftueshme dhe relativisht të mjaftueshme, në raste të caktuara, në funksion të sallave për leksione, laboratorë, zyra, etj. (<i>Evidenca 68</i>).</p> <p>Sipas këtyre të dhënave, Kolegji vë në dispozicion 322 m<sup>2</sup> si salla leksioni për studentët, kundrejt 256 m<sup>2</sup> për klasat. Sallat për veprimtari promovuese shtrihen në 12 m<sup>2</sup> dhe laboratorët informatikë 94 m<sup>2</sup>. Biblioteka ka sipërfaqe 119 m<sup>2</sup>, zyra informative e dedikuar studentëve 15.5 m<sup>2</sup>, dhe mjediset sportive 630 m<sup>2</sup>. Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesoret e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. Ambientet janë të pajisura me dritare dhe me një sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi (<i>Evidenca shitesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Sipërfaqet e dedikuara stafit akademik janë: 57.5 m<sup>2</sup> - salla e mbledhjeve; 23.2 m<sup>2</sup> - mjediset për sekretarinë mësimore; 65 m<sup>2</sup> - njësitë hidrosanitare për stafin.</p> <p>Institucioni ka në përdorim sipërfaqe parkimi.</p> <p>Institucioni siguron 72 m<sup>2</sup> sipërfaqe çlodhëse për studentët. Mjediset hidrosanitare janë në sipërfaqen 125 m<sup>2</sup> (<i>Evidenca 68</i>).</p> <p>Nga vizita në institucion u konstatua se institucioni siguron aksesueshmëri, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion u vërejt se KUB zotëron ambientet e duhura për realizimin e programit mësimor të integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave në drejtësi, ku klasat dhe sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Pajisjet në fjalë, video projektorë, TV, projektorë, kompjutera, pajisje të tjera teknologjike, lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Në godinë funksionin shërbimi i internetit <i>wireless</i>, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit. Rezulton që institucioni ka siguruar e vënë në shfrytëzim pajisjet e duhura e të nevojshme, në funksion të programit të studimeve të ciklit të dytë të studimeve në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 2/2, germa e, dhe nenin 98/1, germa b, të Statutit të tij (<i>Evidenca 1</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të</p>	<p>Në godinë përfshihen laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj. Ambientet e zhvillimit të leksioneve</p>




<p>programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>e seminareve janë me hapësira të mjaftueshme dhe mundësojnë qëndrimin lirshëm të studentëve. Gjithashtu, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektore, etj, dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme (<i>Evidenca 68</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në përputhje me programin e studimit, IAL ka siguruar 2 laboratorë informatike (<i>Evidenca 68</i>). Laboratorët janë pajisur me programe profesionale, që lehtësojnë punën e studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u referua se gjyqet imituese zhvillohen në sallën e gjyqit (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër", RVB, f. 52</i>). <i>Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se pajisjet për një sallë gjyqi ishin vendosur në një ambient të hapur të godinës, jo në një sallë të destinuar posaçërisht për këtë qëllim, arsye për të cilën GVJ sugjeron që IAL të marrë masat e nevojshme për të krijuar sallën e gjyqit në përputhje me programin e studimit në drejtësi, për zhvillimin e gjyqeve imituese.</i></p> <p>Nga ana tjetër, praktikat profesionale dhe disa veprimtari të tjera praktike realizohen në ambientet e subjekteve, me të cilët IAL ka lidhur marrëveshje (<i>Evidenca 48; Evidenca 57</i>).</p> <p><i>Në lidhje me to, GVJ gjen rastin të rekomandojë lidhjen e marrëveshjeve me institucione të tillë si gjykata, prokuroria, institucione të tjerë qendrorë të rëndësishëm, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e përfshirë në njësitë administrative me karakter</p>



<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>administrativ të KUB (<i>Evidenca 2, neni 4</i>). Si në pikëpamje të akteve të brendshme të institucionit, ashtu dhe në atë objektive, rezulton që biblioteka të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte vendosur në katin përdhe të godinës, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>KUB zotëron një bibliotekë me larmi botimesh, ndër të cilët përfshihen dhe ato në fushën e së drejtës, në gjuhën shqipe dhe atë angleze (<i>Evidenca shtesë "Klasifikimi në Library Congress"; Evidenca shtesë "Lista e titujve që kanë hyrë vitet e fundit"</i>). Sipas RVB, f. 52, biblioteka e institucionit siguron një gamë të gjerë titujsh, rreth 26 000, të përzgjedhur në pëputhje me programet e studimit të ofruar nga ky universitet. KUB boton revistën periodike "<i>Beder Journal of Humanities</i>", ku ndër të tjera botohen dhe artikuj e punime në fushën e së drejtës. Këto punime mund të aksesohen online: <a href="http://bjh.beder.edu.al/">http://bjh.beder.edu.al/</a>. Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe angleze, garanton përmbushjen e objektivave të programit për studentët (<i>Evidenca shtesë "Lista e titujve që kanë hyrë vitet e fundit"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e kryer në institucion dhe sipas të dhënave të vëna në dispozicion, institucioni ka siguruar akses pa pagesë për studentët në bibliotekën online "Jstore", në të cilën studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh, në përputhje me programin e studimit (<i>Evidenca 40</i>). Aksesimi në bibliotekën online sigurohet në bazë të abonimit, është pa pagesë për përfituesit e saj si dhe mund të arrihet nëpërmjet shërbimit <i>wifi</i> të internetit, në të gjithë ambientet e IAL. GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekën online dhe bazat e tjera të të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, në përputhje me sa deklaruar nga institucioni në RVB (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi që biblioteka e KUB është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Njëra prej hapësirave të saj përmban zonën e kompjuterave dhe aksesorët e tjerë të nevojshëm. Për të përfituar nga fondi i bibliotekës, studentët mund të paraqesin vërtetimin ose kartën e studentit. (<i>Evidenca 18, neni 6</i>).</p> <p>Sipas RVB, f. 53, dhe nga vizita e kryer, konstatohet që databaza e bibliotekës gjendet dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit (<a href="https://library.beder.edu.al/">https://library.beder.edu.al/</a>). Sistemi i përdorur në funksion të shfrytëzimit shërben për regjistrimin e materialeve, sistemin e klasifikimit të bibliotekës si dhe për procedurat e</p>

66




	katalogimit të koleksionit kryesor ( <i>Evidenca shtesë "Klasifikimi në Library Congress"</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Sipas RVB, f. 53, institucioni parashikon fondet përkatëse për blerjen e literaturës së specializuar, duke i dhënë çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës ( <i>Evidenca 44</i> ). Nga aktet rezulton se institucioni ka miratuar "Udhëzimin mbi funksionimin e bibliotekës". Pas shqyrtimit të tij, <i>GVJ sugjeron që në përmbajtje të këtij akti të përfshihet dhe procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj</i> . Sipas nenit 12 të këtij udhëzimi, si burim i literaturës në bibliotekë parashikohen dhe dhurimet ( <i>Evidenca 18</i> ). Përcaktimi i saktë i procedurës do të vinte në harmoni me sa parashikon "Plani strategjik institucional", ku përmendet dhe biblioteka ( <i>Evidenca 3, pika H, 1, 1.</i> ).			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Oraret e punës së bibliotekës në KUB janë të disponueshme për studentët nga dita e Hënë deri ditën e Premte në orarin 08.30 – 19.00, ditën e Shtunë ora 09.00 – 15.00. Oraret e ofrimit të këtij shërbimi vijnë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe tej tyre, duke iu dhënë mundësi studentëve të shfrytëzojnë dhe tej orarit mësimor literaturën e gjendur në të. Orari është i shpallur në hyrje të bibliotekës si dhe në faqen online të universitetit: <a href="https://library.beder.edu.al/about">https://library.beder.edu.al/about</a> . Gjithsesi, biblioteka, në varësi të nevojave të studentëve, funksionon dhe gjatë ditëve të pushimit, sidomos gjatë sezonit të provimeve ( <i>RVB, f. 53; Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas përcaktimeve të bërë në aktet e brendshme të KUB, në institucion funksionojnë njësitë ndihmëse si zyra e sekretarisë mësimore, e cila disponon dhe administron informacionin që lidhet me studentët. Nëpërmjet strukturave të tij, si të natyrës akademike, ashtu dhe administrative, universiteti siguron mbështetje të vazhdueshme ndaj studentëve në të gjithë aspektet. Për këtë qëllim janë ngritur strukturat përkatëse, të përshkruara në statut, që bëjnë




	<p>të mundur shkëmbimin e të dhënave mes njërive drejtuese, akademike dhe njërive të tjera ndihmëse apo të shërbimit (<i>Evidenca 2; neni 4; Evidenca 5, neni 23</i>).</p> <p>KUB ka krijuar dhe një sistem të automatizuar të dhënash për studentët, duke administruar: gjeneralitetet, numrin e identifikimit, të dhënat e kontaktit, datën e regjistrimit, statusin e regjistrimit të lëndëve, transkriptin, statusin e komunikimit me bibliotekën, etj. Në këtë sistem, zyra e burimeve njerëzore bën shpërndarjen e orëve dhe emrat e pedagogëve respektivë, përpara hapjes së sistemit të regjistrimit të lëndëve për studentët (<i>Evidenca 26</i>). Aksesit në këto të dhëna realizohet në faqen elektronike të institucionit: <a href="https://bis.beder.edu.al/">https://bis.beder.edu.al/</a>.</p> <p>Informacioni për studentët administrohet në <i>database</i>-n e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. Në sekretari gjenden të arkivuara dosjet e secilit student të regjistruar, të çregjistruar apo që ka përfunduar studimet, gjë që u konstatua dhe nga GVJ (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Institucioni disponon gjithashtu të dhëna për studentët nga momenti i regjistrimit deri në dalje nga ky program studimi (<i>Evidenca 73; Evidenca 75; Evidenca 23, f. 18</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme, brenda KUB janë krijuar strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan ngritja dhe funksionimi i sistemit BIS (<i>Evidenca 5, neni 23; Evidenca 26</i>).</p> <p>Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ (<i>Evidenca 26; Evidencat 52; 53; 54; 58; 59; 60</i>). Të dhënat në fjalë, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ka vënë, gjatë vizitës në institucion, në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Gjithashtu, janë të administruara të dhëna lidhur me veprimtaritë ku është përfshirë stafi, si të natyrës sociale (<a href="https://www.beder.edu.al/sh/news/other_categories/categories/8">https://www.beder.edu.al/sh/news/other_categories/categories/8</a>), ashtu dhe pjesëmarrja në trajnime të ndryshme (<i>Evidenca 33; Evidenca 45</i>).</p> <p>Sistemi i brendshëm disponon të dhëna për pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra nga stafi akademik (<i>Evidenca 27; Evidenca 45; Evidenca 71</i>). Nga ana tjetër, departamenti i</p>



	Drejtësisë administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre ( <i>Evidenca 23</i> ).
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezultojnë që strukturat përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Drejtësi, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët. Dhënia e informacioneve të nevojshëm është në përputhje me llojet e programeve të studimit të ofruar nga ky universitet e konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Koordinimi për hartimin e kurrikulave të programeve dhe rregulloreve mundësohet në bazë të dokumentit të hartuar për këtë qëllim (<i>Evidenca 15</i>);</li> <li>- Të dhëna të hollësishme mbi programet e studimit jepen në rregulloret përkatëse si dhe në guidën e studentit (<i>Evidenca 5; Evidenca 9; Evidenca 25</i>). Gjatë vizitës në institucion rezultoi se të dhënat mbi programin e studimit iu jepen studentëve në ditën e prezantimit dhe orientimit të tyre (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Të dhënat mbi kalendarin akademik dhe aktet përkatëse, aksesohen dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL: <a href="https://www.beder.edu.al/">https://www.beder.edu.al/</a>;</li> <li>- Sa i përket syllabus-it të secilës lëndë, ky iu jepet studentëve në orën e parë të kursit, gjithashtu iu dërgohet studentëve në adresën elektronike ose përfshihet në faqen e kurseve në internet (<i>Evidenca 25, f. 9-10; Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>);</li> <li>- Sa i përket procesit të zhvillimit të kurrikulës, zhvillohet duke bërë vlerësimin e programit, me përfshirjen e të gjithë subjekteve të interesuar (<i>Evidenca 15</i>);</li> <li>- Sa i përket kriterëve të pranimit të studentëve, universiteti i përcakton në bazë vjetore sipas vendimmarrjes së strukturave përkatëse (<i>Evidenca 2, neni 57</i>). Kriteret deklarohen në MASR dhe agjencitë e saj, publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe në portalin U-Albania;</li> </ul> <p>Shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve ka funksionuar më së miri edhe gjatë periudhës së pandemisë, të shkaktuar nga Covid-19, nëpërmjet sistemit BIS (<i>Evidenca 16; Evidenca 26</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit</p>	<p>Sipas RVB (f. 54), institucioni ka krijuar mundësinë e komunikimit midis stafit akademik dhe studentëve përgjatë gjithë vitit akademik. Në radhë të parë, i gjithë kampusi ka akses në internet në tërësinë e ambienteve të tij. Studentët mund të njihen me vlerësimet e marra (notat) në sistemin BIS, sipas mënyrës së aksesit të mundësuar nga vetë institucioni. Nëpërmjet këtij sistemi mundësohet komunikimi dhe me struktura administrative të</p>




ndërmjet personelit dhe studentëve.	institucionit ( <i>Evidenca 26</i> ). Komunikimi është verbal, por dhe me anë të postës elektronike, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion në takimet me personelin dhe studentët ( <i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i> ). Gjithashtu, mundësohet komunikimi nëpërmjet platformës Google për arsim, nëpërmjet postës elektronike përkatëse, që shfaqet në faqen elektronike zyrtare të IAL: <a href="http://webmail.beder.edu.al/">http://webmail.beder.edu.al/</a> . Për aksesimin, koordinimin dhe organizimin e materialeve mësimore përdoret platforma "G-Suite" ( <i>Evidenca 69</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Rregullimi i brendshëm i veprimtarisë së KUB, nëpërmjet statutit dhe rregulloreve, është bërë në mënyrë të tillë që strukturat drejtuese dhe titullarët të marrin dijeni për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ ( <i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca 6</i> ). Vlen të përmendet në këtë drejtim edhe përpilimi i raportit vjetor të institucionit, nëpërmjet të cilit përshkruhen veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme studentore, akademike dhe administrative të tij. Raporti në fjalë përgatitet nga të gjitha strukturat akademike, administrative dhe të menaxhimit, nën drejtimin e rektoratit. Ky i fundit, është përgjegjës për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve dhe për përgatitjen e raportit vjetor, i cili i paraqitet në vijim për miratim Senatit dhe Bordit të Administrimit ( <i>Evidenca 1, neni 9/2, germa m, në lidhje me nenin 30/2, germa j</i> ).			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	KUB mundëson dhënien e një informacioni të plotë e të detajuar në faqen zyrtare online të veprimtarisë së tij, <a href="https://www.beder.edu.al/sh/">https://www.beder.edu.al/sh/</a> , si në lidhje me objektivat, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Informacioni mundësohet si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në gjuhën angleze, në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën Nr. 5 të VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë". Për departamentin e Drejtësisë, të dhënat gjenden në të dy gjuhët, në faqen zyrtare elektronike: <a href="https://law.beder.edu.al/">https://law.beder.edu.al/</a> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përkrahje Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, KUB është person juridik jofitimprurës, me karakter ndërkombëtar, i themeluar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Institucioni administrohet nga Fondacioni “Hafiz Ali Korça”, fondacion i cili është themeluar po nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me qëllim të posaçëm administrimin e këtij institucioni të arsimit të lartë. Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare. KUB, pjesë e fondacionit, gëzon autonomi financiare dhe në bazë të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, harton planin buxhetor afatmesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili përditësohet çdo vit (<i>Evidenca 1, neni 95</i>).</p> <p>Hartimi i projektbuxhetit një-vjeçar bëhet në fillim të çdo viti akademik nga administratori, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3 – vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përkatëse (duke mbajtur parasysh nevojat e tyre), duke u miratuar fillimisht nga Bordi i Administrimit e mandej nga Senati Akademik (<i>Evidenca 1, neni 95 në lidhje me nenet 30/2, gërma f dhe 54/6, gërma a</i>).</p> <p>Burim i financimit sipas statutit janë të ardhurat nga: kapitali i themeluesit dhe pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij; të ardhura të krijuara; donacione; burime të tjera të ligjshme (<i>Evidenca 1, neni 93</i>). Në të ardhurat e KUB përfshihen: tarifat e studimeve; të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë; të ardhura nga shërbimet në fushën e botimeve, etj.; të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara; të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim palëve të treta si qiradhënie, etj.; dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike e private; të ardhura që krijohen nga organizimi i konferencave, workshop-eve, konsulencave; financime të tjera të ligjshme (<i>Evidenca 1, neni 95</i>). Referuar të dhënave të sjella nga institucioni, të ardhurat faktike janë siguruar nga grantet për kërkim dhe kontratat, konsulencat dhe shërbimet, tarifat e shkollimit, donacionet (<i>Evidenca 70</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, RVB dhe aktet shoqëruese, rezulton se në buxhetin afat-mesëm dhe atë të vitit fiskal të KUB, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve, të cilët ndahen në tre kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Shpenzime për mësimdhënie dhe shkencë;</li> <li>2) Shpenzime të administrimit institucional dhe,</li> </ol>



<p>procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>3) Shpenzime të përgjithshme operative.</p> <p>Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Gjatë hartimit të planit mbahen parasysh gjithashtu kërkesat për sigurimin e cilësisë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, bibliotekën <i>online</i>, etj (F. 55 e RVB). Po ashtu, plani i financimit pasqyron grantet e huaja të përfituara dhe kontratat e lidhura, në përputhje me plotësimin e objektivave që janë vendosur për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Drejtësi (Evidenca 28).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, veprimtaria e KUB i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm nga një kontabilist i miratuar, me porosi të fondacionit, pjesë e të cilit është IAL në fjalë, raport i cili ruhet pranë fondacionit (Evidenca 1, neni 96; RVB, f. 55).</p> <p>Në RVB (f. 55) është pasqyruar se raporti i auditit përmban në mënyrë të detajuar situatën financiare si dhe të dhëna për përdorimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e programit mësimor. Të dhënat përfshijnë gjithashtu buxhetin e vitit të kaluar, projektbuxhetin e vitit të ardhshëm akademik dhe projektbuxhetin afatmesëm.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga aktet rezultojnë se raportet financiare janë të administruara për tri vitet e fundit akademike (Evidenca shtesë 9 "Projekt buxheti për 3 vite akademike"). Rektorati përgatit raportin financiar, bazuar në planifikimet e kryera në programin financiar. Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi i Administrimit dhe në përfundim të këtij procesi bëhet dhe analiza që planifikon ndërhyrjet e duhura në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit (Evidenca 1, neni 30).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe</p>	<p>Pasur parasysh dokumentacionin e konsultuar, vlerësohet se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit Master i Shkencave në Drejtësi, me profile. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Drejtësisë. Në këtë pikë, pasur parasysh burimet e të ardhurave faktike dhe faktin se pjesën dërrmuese të të ardhurave e përbëjnë tarifatat e shkollimit, <b>vlerësohet</b></p>



gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<i>shtimi dhe i faktorëve të tjerë në të ardhurat institucionale (sipas parashikimeve të vetë statutit të KUB), për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion del në pah që KUB ka hartuar procedura të hollësishme për regjistrimin e studentëve, periudhën e studimeve dhe diplomimin e tyre ( <i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca 4; Evidenca 9</i> ). Aktet e brendshme janë hartuar duke pasur parasysh përcaktimet e ligjit Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Mbi bazën e akteve themelore të organizimit të brendshëm, institucioni ka ngritur një sërë zyrash dhe zbaton procedura që mbulojnë momentin e regjistrimit, pranimit, transferimit, lënies së studimeve, këshillimit gjatë periudhës së studimeve, diplomimin e studentëve ( <i>Evidenca 12; Evidenca 20; Evidenca 25; Evidenca 42; Evidenca 50; Evidenca 78; Evidenca 79</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	KUB ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhdimin të studimeve, të mirëpërcaktuara dhe të bëra publike, garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student ( <i>Evidenca 1, nenet 4/1 dhe 5</i> ). Këto parime përmenden dhe në planin strategjik të universitetit, në drejtëm të ofrimit dhe dhënies së mundësive të barabarta për të gjithë studentët apo kandidatët për të qenë të tillë ( <i>Evidenca 3, pika C</i> ).



**Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteret dhe procedurat mbi pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015. Procedura të hollësishme janë parashikuar në rregulloren themelore, rregulloren e studimeve të ciklit të dytë dhe në atë të transferimeve (*Evidenca 2; Evidenca 9; Evidenca 12*). Kriteret e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare elektronike të institucionit (<http://mco.beder.edu.al/pages.php?id=21>), e aksesueshme lehtësisht nga cilido i interesuar.

Sa u përket procedurave të tjera gjatë vazhimit të studimeve, përfshi transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, institucioni ka krijuar mekanizmat përkatës, rregullore dhe zyrtar zbatuese të tyre. Informacione të hollësishme studentëve iu sigurohen dhe përmes Guidës së studentit (*Evidenca 25*) si dhe në faqen *online* të universitetit. Informacioni është lehtësisht i kuptueshëm dhe përfshin të dhënat e nevojshme. Pranimi i studentëve që ndjekin programin e integruar të studimeve në drejtësi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i KUB dhe Rregullorja e studimeve të ciklit të dytë (*Evidenca 1; Evidenca 9*).

Pasur parasysh dhe rregullimet e VKM Nr. 259, datë 10.05.2019, të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë personat që zotërojnë diplomë të nivelit të parë, diplomë të nivelit të dytë, diplomë DIND, diplomë studimi të sistemit të mëparshëm, të pandarë në cikle studimi ose diplomë tjetër universitare të fituar jashtë vendit dhe e barasvlerësuar nga Ministria e Arsimit. Gjithashtu, ndër kriteret e pranimit është dëshmia e njohjes së një prej 5 gjuhëve të huaja: angleze, frënge, gjermane, italiane dhe spanjolle, me nivel minimal B1. Kandidati duhet të pranojë pagesën e tarifës së caktuar mujore ose vjetore (*Evidenca 2, neni 58; Evidenca 9, neni 15*).

Neni 22 i Rregullores së studimeve të ciklit të dytë përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur (*Evidenca 9*). Procedura të tjera të detajuara gjenden në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë dhe në atë të transferimeve. Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukture dhe kriteret e pranimit të vendosura nga njësitë bazë e njësitë kryesore (*Evidenca 2, neni 57; Evidenca 9, neni 14*).

Nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve në sekretarinë mësimore, rishtas dhe të transferuar, përzgjedhur në mënyrë rastësore, u konstatua se në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit, përkatësisht në nenet e cituar më lart të Rregullores





	themelore, Rregullores së studimeve të ciklit të dytë dhe Rregullores së transferimeve. Nuk u konstatuan probleme sa i përket matricullimit të studentëve ( <i>Evidenca shitesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Neni 76 i Statutit dhe neni 57/3 i Rregullores themelore parashikojnë kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët shpallen dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve ( <i>Evidenca 1; Evidenca 2</i> ). Konkretisht, sipas këtyre neneve dhe nenit 5 të Rregullores së programit, për programin e ciklit të dytë të studimeve është vendosur si kriter pranimi njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të BE ( <i>Evidenca 4</i> ). Kriteret për këtë program studimi rezultojnë të publikuara dhe në faqen zyrtare të institucionit: <a href="http://mco.beder.edu.al/pages.php?id=21">http://mco.beder.edu.al/pages.php?id=21</a> .			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Sipas RVB, f. 56, institucioni mban lidhje të vazhdueshme me drejtoritë rajonale arsimore dhe nëpërmjet panairëve të karrierës në qytete të ndryshme të vendit, përmes të cilave, maturantët njihen me mundësitë akademike që ofron ky IAL. KUB realizon udhëzimin e të interesuarve lidhur me kriteret e përgjithshëm dhe të veçantë të këtij programi studimi, përpara fillimit të çdo viti akademik nëpërmjet strukturave të brendshme të tij, publikimeve të ndryshme, takimeve e panairëve ( <i>Evidenca 3, pika C</i> ) si dhe nëpërmjet faqes elektronike zyrtare: <a href="http://mco.beder.edu.al/">http://mco.beder.edu.al/</a> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe nga vizita në institucion, mund të konfirmohet se këta të fundit marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit. Informacioni për këtë program studimi gjendet i qartë dhe në faqjen online të universitetit: <a href="http://mco.beder.edu.al/pages.php?id=13">http://mco.beder.edu.al/pages.php?id=13</a> .  KUB organizon që në javën e parë të vitit akademik një javë orientuese, ku marrin pjesë studentët, personeli akademik dhe ndihmës akademik, me qëllim informimin e studentëve mbi




	<p>objektivat e programit të studimit, arritjet në fund të tij dhe kriteret për kalimin në vitin pasardhës akademik (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Informacioni iu jepet nga departamenti i Drejtësisë dhe sekretaria mësimore me fokus kryesor kalendarin e vitit akademik, kurrikulën mësimore, orarin e semestrit të parë, stafin akademik të angazhuar në këtë semestër. Takimet vijojnë dhe gjatë semestrit pasardhës (<i>Evidenca 25</i>). Të dhëna mbi lëndën dhe syllabus-in e saj, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe detyrimet, studentët i marrin në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga pedagogu përkatës (<i>Evidenca 66</i>). Vlerësimet e lëndëve të programit iu bëhen të ditur studentëve nga sekretaria mësimore nëpërmjet adresave elektronike ose drejtpërdrejt (<i>Evidenca 26</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>KUB njih mundësinë e transferimit të studentëve në vite ndërmjetëse brenda të njëjtit cikël, në programe të njëjta ose të ngjashme studimi, brenda të njëjtit institucion ose në IAL të tjera, vendase apo të huaja si dhe transferimin në IAL të tjerë (<i>Evidenca 1, neni 77; Evidenca 2, nenet 69-73; Evidenca 4, neni 12; Evidenca 12</i>). Procedura e përcaktuar në këto akte është e qartë, në drejtim të njohjes së studimeve të kryer më parë nga studenti. Me qëllim njohjen e këtyre studimeve të mëparshme, këshilli i departamentit ngre Komisionin <i>ad hoc</i>, i cili ndjek të gjitha procedurat e nevojshme (<i>Evidenca 2, neni 14</i>).</p> <p>Informacioni mund të merret në strukturat administrative dhe në nivel departamenti, sikundër edhe përmes Guidës së studentit (<i>Evidenca 23</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rezultoni që studentët informohen mbi programin e studimit, në mënyrë të detajuar dhe për kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të tyre. Ky informacion iu sigurohet në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga departamenti si dhe pedagogu përkatës (<i>Evidenca 66</i>). Të dhënat mund të aksesohen nga studentët nëpërmjet sistemit BIS (<i>Evidenca 26</i>), po ashtu dhe në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://law.beder.edu.al/sh/content/default/master-of-sciences-in-law-criminal-law-profile/372/374">https://law.beder.edu.al/sh/content/default/master-of-sciences-in-law-criminal-law-profile/372/374</a> dhe <a href="https://law.beder.edu.al/sh/content/default/master-of-science-in-law-international-law-profile/372/375">https://law.beder.edu.al/sh/content/default/master-of-science-in-law-international-law-profile/372/375</a>.</p> <p>Në sistemin BIS studentët gjejnë vlerësimet për secilën lëndë, pjesëmarrjen dhe mesataren (<i>Evidenca 26; Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të</p>	<p>Orientimi i studentëve lidhur me diplomimin kryhet nga departamenti, i cili iu siguron informacionin e nevojshëm. Atyre iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të vitit akademik rreth</p>





<p>diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit (<i>Evidenca 23, f. 15</i>).</p> <p>Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka parashikuar procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj (<i>Evidenca 9, nenet 39-41; Evidenca 4, nenet 17-19</i>). Studenti asistohet nga një udhëheqës gjatë punimit të temës dhe gjithë ecuria e punës shënohet në një formular që mbahet për këtë qëllim (<i>Evidenca 79</i>).</p> <p>Në funksion të plotësimit të kriterit, institucioni ka hartuar dhe miratuar një manual për punimin e temës që lehtëson punën e studentëve, por dhe të stafit akademik, i cili nuk gjendet në dokumentacionin e vënë në dispozicion, por është i publikuar në faqen zyrtare të institucionit: <a href="http://mco.beder.edu.al/uploads/docs/dc_30.pdf">http://mco.beder.edu.al/uploads/docs/dc_30.pdf</a>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka publikuar udhëzues të posaçëm siç është Guida e studentit (<i>Evidenca 25</i>), i cili gjendet dhe online: <a href="https://www.beder.edu.al/static/docs/guida_e_studentit_shqip_17_4_710.pdf">https://www.beder.edu.al/static/docs/guida_e_studentit_shqip_17_4_710.pdf</a>; të dhëna për këtë kriter gjenden dhe në faqen zyrtare online të universitetit.</p> <p>Gjithashtu, institucioni, nëpërmjet strukturave kompetente dhe Departamentit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, organizon takime të hapura për të informuar të interesuarit dhe studentët mbi programin e studimit (<i>RVB f. 57</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe</p>	<p>Studentët marrin informacione të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve që do të ndjekin, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai administrativ i universitetit. Vlen të përmendet në lidhje me këtë kriter, orientimi që</p>



<p>kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>marrin studentët në fillim të çdo viti akademik mbi programin e studimit (<i>Evidenca 23</i>).</p> <p>Këshilltari akademik është një ndër figurat që sigurojnë informacionin e vazhdueshëm të nevojshëm sa i përket çështjeve që lidhen me infrastrukturën, organizimin e studimeve dhe orientimin pas studimeve (<i>Evidenca 6, neni 18</i>). Rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luajnë dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare elektronike të KUB.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe pedagogët e secilës lëndë, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat administrative të KUB, sigurojnë dhënien e informacioneve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabus-et e detajuar, praktikat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit. Informimi mundësohet si në fillim (kryesisht), por dhe në vijim të vitit akademik. Ky është një detyrim që buron nga aktet e brendshme rregulluese të IAL (<i>Evidenca 9, kreu III; Evidenca 4</i>). Informimi mundësohet në periudha të ndryshme të vitit akademik (<i>Evidenca 23</i>).</p> <p>Të dhëna të hollësishme dhe informacionet e nevojshme përsa më lart gjenden dhe në Guidën e studentit (<i>Evidenca 25</i>). Mandej, informacionet për planprogramet e kursit gjenden dhe të shpallura online në faqen: <a href="http://mco.beder.edu.al/">http://mco.beder.edu.al/</a>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në nenin 3 të Rregullores së studimeve të ciklit të dytë dhe në nenin 3 të Rregullores së programit, përcaktohet se programi synon që t'u ofrojë mundësi studentëve për të thelluar njohuritë e tyre, me qëllim përgatitjen e studentëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë e më gjerë (<i>Evidenca 9, neni 3; Evidenca 4, neni 3</i>). Në përputhje me këta rregullime dhe aktet e tjerë të brendshëm (<i>Evidenca 2, neni 4; , në RVB</i>) pasqyrohet se brenda KUB është ngritur dhe funksionon Zyra e Planifikimit të Karrierës, nëpërmjet së cilës këtyre të fundit iu ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. Kjo zyrë funksionon pranë dekanatit të studentëve, ku çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, që ofron këshillim për studentët e regjistruar (<i>RVB, f. 58</i>). Referohet që këshilltari i karrierës informon studentët me e-mail mbi organizimin e veprimtarive që lidhen me punësimin, kërkon mundësi punësimi si dhe organizon aktivitete të cilët synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre. Kjo zyrë përmendet si një ndër strukturat që nxit zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare (<i>Evidenca 23, f. 30</i>).</p>



	<p>GVJ konstaton që në Rregulloren themelore të IAL përcaktohet se dekanati i studentëve ka në varësinë e tij katër zyra, të cilat organizohen dhe funksionojnë sipas përcaktimeve të bërë në rregulloren “Për organizimin administrativ” të institucionit (<i>Evidenca 2, neni 50/4 në lidhje me nenin 4</i>).</p> <p>Institucioni ka të miratuar rregulloren për organizimin administrativ (<i>Evidenca shitesë 3 “Rregullorja mbi organizimin administrativ”</i>), në nenin 41 të së cilës përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit për planifikimin e karrierës.</p> <p><b>GVJ vlerëson se me rëndësi në këtë drejtim do të ishte dhe hartimi i një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacionin e plotë lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, studentët e marrin që në leksionin e parë (<i>Evidenca 23</i>). Në këtë drejtim, vlen të përmendet dhe roli i këshilltarit akademik, i cili siguron udhëzime për secilin student në të gjitha çështjet akademike (<i>Evidenca 6, neni 18</i>). Të dhëna të tjera të hollësishme mbi procesin mësimor studentët marrin dhe nëpërmjet Guidës së hartuar posaçërisht për ta (<i>Evidenca 25</i>). Sipas RVB, f. 58, strukturat e departamentit dhe ato mbështetëse të institucionit mundësojnë që në mënyrë të vazhdueshme, studentët të marrin të dhënat e nevojshme mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e tjera që i vlejnë programit të studimit. Përshkrimi i tyre iu bëhet që në fillim të programit, gjithashtu studentët apo të interesuarit, kanë mundësi të shohin nga afër mjediset e IAL në vizitat që mundësohen për këtë qëllim (<i>Evidenca 23</i>). Informacioni i përditësuar gjendet dhe në faqen zyrtare elektronike të KUB.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita e kryer në institucion dhe nga takimi me studentët, konstatohet që strukturat përgjegjëse në rang akademik dhe administrativ kanë mundësuar dhënien e informacionit në mënyrë të saktë e të kuptueshme. Ky informacion ka qenë lehtësisht i arritshëm edhe në distancë (sidomos gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19), duke realizuar shkëmbimin e të dhënave në rrugë elektronike (nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit: <a href="https://www.beder.edu.al/sl/content/default/covid--19-14-17/4/655">https://www.beder.edu.al/sl/content/default/covid--19-14-17/4/655</a>, postës elektronike, etj) (<i>Evidenca 16</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin</p>	<p>Në përputhje me nenin 48 të Rregullores themelore statutit të IAL, sekretaria mësimore është përgjegjëse, ndër të tjera, për të ruajtur informacionin, dokumentacionin dhe dokumentet që ilustrojnë aktivitetin mësimor të studentëve (<i>Evidenca 2</i>).</p>





dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Zyra e sekretarisë mësimore administron dosjet personale të studentëve, të dhënat që lidhen me provimet përfundimtare dhe notat përfundimtare të vlerësimit të tyre, të cilat gjenden dhe në sistemin BIS të këtij universiteti ( <i>Evidenca 26</i> ). Këto të dhëna të administruara u konsultuan gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ, si dosje të studentëve, ashtu dhe procesverbale të vlerësimit të tyre, dokumente të cilët u gjetën të rregullt në formë dhe përmbajtje ( <i>Evidenca shitesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i> ).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përfundim	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar për programin e studimit për secilin vit akademik objekt shqyrtimi. Të dhënat përfshijnë statistikën e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, aktivitetet ku janë përfshirë, studentët e diplomuar dhe të dhënat mbi punësimin e tyre ( <i>Evidenca 73; Evidenca 74; Evidenca 75; Evidenca 23, f. 18</i> ).



**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.

Institucioni zotëron të dhënat e nevojshme statistikore për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara, për programin e studimeve të ciklit të dytë. Të dhënat administrohen nga sekretaria mësimore, në dokumentacionin e mbajtur për këtë qëllim (*Evidenca 23, f. 18; Evidenca 73; Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"*).

Referuar *Evidencës shtesë Tabela Nr. 21 MSC Profile Drejtësi* dhe vizitës në institucion numri i studentëve për këtë program studimi sipas profileve rezulton:

Profili i programit	Viti akademik	Të regjistruar
Msc Drejtësi profili "E Drejtë Penale"	2019-2020	15
	2020-2021	15
	2021-2022	20
<b>Totali</b>		<b>50</b>

Profili i programit	Viti akademik	Të regjistruar
Msc Drejtësi profili "E Drejtë Ndërkombëtare"	2019-2020	0
	2020-2021	8
	2021-2022	7
<b>Totali</b>		<b>15</b>

**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Institucioni disponon në mënyrë të saktë të dhënat e nevojshme që tregojnë ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve, nga regjistrimi deri në diplomim, fakt i cili vërtetohet nga dokumentacioni (*Evidenca 73; Evidenca 75; Evidenca 23, f. 18*), ashtu dhe nga dokumentet e depozituar në sekretarinë mësimore si regjistra, procesverbale të notave (në përputhje me nenin 48 të Rregullores themelore – *Evidenca 2 -*), etj. (*Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"*). Gjithashtu, të dhënat në fjalë gjenden në bazën e të dhënave BIS (*Evidenca 26*).

**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen të përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Nga aktet e konsultuar vërehet që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, janë mbajtur në mënyrë të saktë dhe mund të aksesohen me lehtësi. Aksesimi në to mundësohet nga baza e të dhënave BIS, ku të dhënat mbrohen nga fjalëkalimet e krijuar për këtë qëllim dhe nivelet përkatës të hyrjes (*Evidenca 26*).

**Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike

Sipas RVB, f. 60, strukturat përgjegjëse si departamenti, janë të përfshirë në procesin e krijimit të raporteve analitike mbi profilin dhe





periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe të shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre. Të dhënat e hartuara dhe të përpunuara shërbejnë si bazë për marrjen e masave të nevojshme me qëllim përmirësimin e këtyre treguesve ( <i>Evidenca 23, f. 29-31</i> ).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në vështrim të nenit 98/1, gërma c, të ligjit Nr. 80/2015, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë. Në përputhje me këtë parashikim ligjor, në nenin 98/1, gërma c, në lidhje me nenet 10/1, 28/2, 89/1 e 99 të statutit të KUB, përcaktohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e këtij universiteti dhe përfaqësohen në Senat, NJSBC, Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Këshillat Studentorë ( <i>Evidenca 1</i> ). Po ashtu, me vendim të Senatit, studentët janë përfshirë në këshillin e departamentit dhe atë të fakultetit, duke marrë pjesë në mbledhjet e zhvilluara ( <i>Evidenca 49</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	E drejta për pjesëmarrje në vendimmarrjen e KUB është garantuar në mënyrë efektive, kjo si në pikëpamje të akteve të brendshme rregulluese, ashtu dhe nga pohimet e studentëve, gjatë takimit të zhvilluar me ta. Emrat e studentëve, anëtarë të senatit, etj., mund të konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare elektronike të institucionit ( <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/anetaret-e-senatit-14-9/419/422">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/anetaret-e-senatit-14-9/419/422</a> ) si dhe në dokumentacion ( <i>Evidenca 76</i> ). Gjithsesi, nuk bëhet dallimi nëse bëhet fjalë për studentë të programit të parë apo të dytë të studimeve, përfaqësues në këto struktura. Mendimet e studentëve mblidhen në mënyrë periodike dhe shqyrtohen nga institucioni me qëllim marrjen e masave për ndërmarrjen e veprimeve në të ardhmen ( <i>Evidenca 10, neni 11</i> ).



	<p>Një prej studentëve është dhe anëtar i GVB (<i>Evidenca 36; RVB dhe evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p> <p>Në RVB, f. 61, vihet në dukje se vlerësimi i rezultateve të mësimdhënies është pjesë e të dhënave që nxirren nga anketimet e studentëve për secilën lëndë e pedagog, të cilat zhvillohen dy herë në vit (<i>Evidenca 29</i>). Vlerësimi mbi procesin akademik është realizuar dhe gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, nëpërmjet pyetësorëve përkatës (<i>Evidenca 32</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit, objekt vlerësimi, është hartuar duke u mbajtur parasysh ngarkesa e detyrimeve akademike të studentëve, duke pasur në vëmendje shtrirjen e viteve akademike, numrin e lëndëve, etj. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh një ngarkesë akademike të përhapur drejt gjatë vitit. Procedurat e parashikuara janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe synojnë të pakësojnë sa më shumë qasjen burokratike (<i>Evidenca 4</i>). Njohja e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme rezulton e rregulluar nga aktet e brendshme si dhe strukturat e ngritura për këtë qëllim (<i>Evidenca 12, neni 4; Evidenca 9</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>KUB ka garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit në statut dhe në rregulloren themelore. Nga pikëpamja e realizimit të kriterit, studentëve u jepet mundësia të shprehen mbi elementet e programit të studimit (<i>Evidenca 29; Evidenca 32; Evidenca shtesë "Anketë vlerësimi i studentëve për institucionin new"</i>), mendime të cilët merren në shqyrtim nga strukturat përgjegjëse të institucionit, që shpie në rishikim apo përmirësim të këtyre elementeve (<i>Evidenca 10; Evidenca 23</i>).</p> <p>Përfshirja në këtë proces garantohej dhe nga Këshilli Studentor, veprimtaria e të cilit iu bëhet e njohur studentëve dhe online: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/keshilli-studentor-1/7/161">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/keshilli-studentor-1/7/161</a>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga</p>	<p>Krerët 3 dhe 4 të Rregullores së studimeve të ciklit të dytë si dhe nenet 10, 11, 16-19 të Rregullores së programit të studimit përcaktojnë në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës, përfshi dhe procedurën e ankimit (<i>Evidenca 9; Evidenca 4</i>). Me këto rregulla studenti njihet dhe përmes Guidës së studentit (<i>Evidenca 25</i>), e cila është publikuar dhe online. Nga dokumentacioni (<i>Evidenca 23 apo dhe RVB</i>), si dhe nga vizita në institucion, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur me procesin e vlerësimit të dijeve,</p>



ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	pasi çdo pretendim i studentëve që kanë pasur të tillë, është sqaruar nga pedagogu i lëndës ( <i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër", takimet me stafin akademik, studentët dhe vizita në sekretarinë mësimore</i> ).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.6

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni është i angazhuar në fushën e kërkimit shkencor dhe në nxitjen e personelit akademik që të përfshihet në këtë veprimtari ( <i>Evidenca 1, nenet 4, 86-88</i> ). Për këtë qëllim, rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion si dhe nga takimi me stafin akademik, që anëtarët e tij kanë qenë pjesëmarrës në një sërë veprimtarish, si konferenca ndërkombëtare apo veprimtari kërkimore-shkencore ( <i>Evidenca 27</i> ). Në këtë drejtim, universiteti nxit dhe mbështet botimet e punimeve në revista të ndryshme shkencore ( <i>Evidenca 14; Evidenca 22</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Në përputhje me sa është përcaktuar në statut për fushën e kërkimit shkencor, rezulton që KUB të ketë vendosur objektiva të qartë në këtë drejtim dhe të ketë lidhur marrëveshje konkrete ndërkombëtare, në nivel rajonal dhe më gjerë. Objektivat vlejné dhe për stafin akademik të këtij programi të studimeve ( <i>Evidenca 34; Evidenca 48; Evidenca 72; Evidenca 84; Evidenca 9, neni 8</i> ).  Marrëveshjet e përbashkëta synojné në realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. Në funksion të përmbushjes së këtyre synimeve, në këtë universitet është ngritur dhe funksionon zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila ndjek procesin në fjalë ( <i>Evidenca 6, nenet 23, 24</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojné, shkruajné dhe publikojné studime e punime shkencore.	Përfshirja e studentëve në fushën e kërkimit shkencor është një ndër objektivat e stafit akademik të këtij programi studimi ( <i>Evidenca 3, pika D</i> ). Në përputhje me këtë objektiv, studentëve u mundësohet, nëpërmjet zyrës së kërkimit shkencor dhe të projekteve, marrja dijëni për aktivitetet e ndryshme ku mund të prezantojné studime apo punime shkencore ( <i>Evidenca 14, neni 6</i> ).



	<p>Gjatë takimit të zhvilluar në institucion u konfirmua fakti se personeli akademik ka nxitur studentët për t'u angazhuar në veprimtari kërkimore e shkencore; fakt i përmendur dhe në faqen 62 të RVB (<i>Evidenca 74</i>).</p> <p>Të dhënat në fjalë gjenden dhe në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-kerkimit-shkencor-4/8/404">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-kerkimit-shkencor-4/8/404</a>, ku studentët marrin dijeni për këtë fushë të aktiviteteve si dhe ku mund të konsultojnë punimet e botuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet që ka bërë në statut sa i përket fushës së kërkimit shkencor, nga aktet e administruar dhe nga vizita në institucion, konstatohet që universiteti siguron mbështetje për stafin akademik dhe për studentët, në drejtim të publikimit të punimeve të tyre në revista shkencore ndërkombëtare (<i>Evidenca 3, pika B</i>). Për nxitjen e stafit akademik dhe studentëve në këtë drejtim është parashikuar një buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime (<i>Evidenca 14, neni 14</i>). Gjatë vizitës në institucion u konfirmua ky fakt, zbatuar në praktikë përmes vendimmarrjes së rektoratit dhe dokumentacionit përkatës që vërteton mbështetjen e personelit akademik (<i>Evidenca 22; Evidenca shitesë "Shënimet Drejtësi Bedër</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Synimi i institucionit në përgjithësi dhe i personelit akademik të këtij programi studimi në veçanti, për të nxitur dhe mbështetur studentët drejt studimeve inovative, shprehet në aktet e krijuara, që ilustrjnë këtë objektiv (<i>Evidenca 3, pika b -2</i>). Nëpërmjet shembullit të tyre dhe krijimit të mundësive për zbatim të marrëveshjeve me IAL të huaja, kërkohet të arrihet të menduarit ndryshe tek studentët e këtij programi, në përputhje me zhvillimet e reja objektive dhe për dhënien e ideve të reja në fushën e së drejtës. Në fakt disa prej studentëve kanë publikuar punime në "Beder Journal of Humanities", e cila mund të aksesohet dhe online: <a href="http://bjh.beder.edu.al/">http://bjh.beder.edu.al/</a>.</p> <p>Në lidhje me angazhimin në drejtim të patentave, vlerësohet se nuk gjen zbatim për studentët e këtij programi të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Rregullat lidhur me diplomimin e studentëve janë përcaktuar në nenet 39-41 të rregullores së studimeve të ciklit të dytë dhe në nenet 17-19 të rregullores së programit (<i>Evidenca 9; Evidenca 4</i>).</p> <p>Shtjellimi i rregullave për punimin e diplomës është dhënë në mënyrë tepër të përgjithshme në Guidën e studentit (<i>Evidenca 25, f. 24-25</i>), por nuk rezulton të jetë hartuar një udhëzues i posaçëm për punimin e diplomës. Sikundër raportohet dhe në faqen 63 të RVB, gjatë këtij procesi, studentët mbajnë kontakte të rregullta me pedagogët dhe udhëheqësit e tyre, ku sipas nevojave të punimit që është duke u kryer, marrin dhe ndihmën e duhur për secilin nga aspektet që lidhet me punimin e një diplome. Vlen të theksohet se në kurrikulën e</p>



	programit është përfshirë një lëndë e veçantë për punimin e diplomës (Evidenca 82).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi V.7

**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>KUB i ka mëshuar politikës së bashkëpunimit me organizmat shkencorë ndërkombëtarë, duke e shprehur fillimisht këtë në statutin e institucionit dhe në dokumente të tjerë të brendshëm strategjikë (Evidenca 1, neni 4; Evidenca 3, objektivi strategjik A, pika c). Në përputhje me këto përcaktime, brenda institucionit është ngritur dhe funksionon zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare që mundëson vënien në praktikë të politikave të bashkëpunimit (Evidenca 6, neni 23). Gjithashtu, vlen të përmendet dhe hartimi i një strategjie të posaçme të ndërkombëtarizimit që përfshin periudhën 2020-2025 (Evidenca 1.14). Vërehet nga aktet se institucioni ka lidhur disa marrëveshje për arritjen e këtij objektivi, me disa universitete të vendeve të BE-së e më gjerë (Evidenca 48) si dhe është bërë pjesë e programeve Erasmus, për të siguruar mobilitetin e stafit dhe studentëve (Evidenca 34). Nga të dhënat e administruara rezulton që 4 studentë të këtij programi studimi janë mobilizuar nga dhe drejt programit të studimit (Evidenca 72). Mbetet për t'u evidentuar nevoja për shtimin e marrëveshjeve me IAL të huaja, të cilat do të ndihmonin kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik dhe studentëve, sugjerim i cili është dhënë në standardin IV.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Aktet e brendshme të universitetit nxitin stafin akademik në përdorimin e metodave të tilla të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët, në mënyrë që ata të jenë të pajisur me njohuri të thelluara teorike si dhe të aftë për të kryer kërkime shkencore në fushat përkatëse (Evidenca 9, neni 3; Evidenca 4, neni 3; Evidenca 23, f. 12-13). Studentët ndiqen me vëmendje gjatë gjithë jetës së tyre studentore, në punimet që kryejnë dhe veprimtaritë ku marrin pjesë, duke u udhëzuar dhe për politikat e citimit të punimeve të autorëve të tjerë, me qëllim ruajtjen e së drejtës së autorit (Evidenca 4, neni 16). Programet e lëndëve nga ana tjetër, janë ndërtuar në mënyrë të tillë</p>



	që garantojnë po ashtu vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve (Evidenca 4).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Përprjekjet pozitive të universitetit në drejtim të përfshirjes së studentëve vendas dhe të huaj në projekte kërkimore gjejnë shprehje në aktet e brendshme të IAL (Evidenca 1, nenet 86-87; Evidenca 3, pika B). Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri dhe përfshirjen e studiuesve të rinj në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare, vërehet se ka përfshirje të studentëve, pasqyruar në punimet përkatës që mund të konsultohen në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/botime-1-5/8/165">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/botime-1-5/8/165</a> .  GVJ sugjeron që departamenti të intensifikojë përprjekjet për të qenë pjesë e projekteve të tillë si “Jean Monnet”, etj., me qëllim fuqizimin e pjesëmarrjes në projekte kërkimore.
<b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Institucioni ka krijuar bazën e nevojshme në fushën e kërkimit shkencor, ku mund të përfshihen dhe kërkuesit shkencorë të huaj (Evidenca 1, nenet 86-88). Institucioni ka miratuar Rregulloren mbi kërkimin shkencor, ku ka shpalosur politika, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë të kërkimit, ku ndërthuren disiplina të ndryshme të shkencave shoqërore, që nuk përfshijnë vetëm një vend të caktuar. Për arritjen e këtij objekti, universiteti vepron nëpërmjet qendrave të tij kërkimore, që sigurojnë akses dhe për kërkues të huaj (Evidenca 14; Evidenca 6, neni 19).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Politika favorizuese e universitetit ndaj mobilitetit të studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare shprehet mjaft mirë në aktet e brendshme të tij (Evidenca 1, neni 4; Evidenca 3, pika B). Një ndër objektivat e IAL është zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore, me qëllim që t’u ofrohet studentëve përvojë ndërkombëtare (Evidenca 3, pika B). Është Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare struktura, e cila është ngarkuar me detyrën për të mundësuar lëvizjen e studentëve dhe shkëmbimit të studentëve e personelit në përgjithësi (Evidenca 6, neni 23). Praktikisht, KUB realizon mobilitetin përmes programit Erasmus, nga i cili ka përfituar në vijim të aplikimit përkatës (Evidenca 34).
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.	Në përputhje me qëllimin e tij strategjik, universiteti, gjatë realizimit të veprimtarive kërkimore dhe të mësimdhënies, mundëson pjesëmarrjen e personelit akademik të huaj si dhe të studentëve të huaj (Evidenca 3, pika A -c-). Edhe në këtë aspekt, rolin kryesor e luan Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në funksion të strategjisë së ndërkombëtarizimit të KUB, kjo zyrë inkurajon shkëmbimin e stafit për të tërhequr personel ndërkombëtar akademik të kualifikuar



	<p>(Evidenca 6, neni 23). Nga aktet rezulton që në programin e studimit është aktivizuar personel akademik i huaj. Staf akademik i huaj është përfshirë dhe në veprimtaritë e ndryshme të organizuara nga universiteti (Evidenca 72). IAL ka lidhur marrëveshje bashkëpunim me disa institucione të huaja arsimore dhe nëpërmjet organizimit të përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkët kërkimore e shkencorë, u jep mundësinë anëtarëve të stafit akademik të huaj dhe studentëve të huaj, që të marrin pjesë në to (Evidenca 57; Evidenca shtesë "Lista e marrëveshjeve të tre viteve të fundit"; RVB f. 64). Aktivitetet e zhvilluara mund të konsultohen dhe në faqen elektronike të institucionit: <a href="http://iro.beder.edu.al/pages.php?s=49">http://iro.beder.edu.al/pages.php?s=49</a>. Gjithsesi, të dhënat lidhur me këtë kriter sugjerohet që të mbahen të detajuara nga ana e institucionit, në lidhje me stafin akademik të huaj dhe studentët e huaj, që angazhohen për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.8

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>KUB ka parashikuar procedura e njësi të posaçme në drejtim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve në rregulloren themelore dhe në rregulloren e programit, siç janë zyra e pranimeve, sekretaria mësimore, zyra e planifikimit të karrierës, dekanati (Evidenca 2, neni 4), me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e nënshkrimit të kontratës me IAL (Evidenca 2, neni 62 dhe Evidenca 9, neni 25) si dhe nëpërmjet guidës së studentit (Evidenca 25). Informimi dhe shërbimi ndaj studentit realizohet nga sekretaria mësimore, në nivel departamenti si dhe një rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt luan dhe këshilltari akademik (Evidenca 2, neni 63). Gjithashtu, informacionin e nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet përkatëse janë të publikuara dhe në faqen online të KUB: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/programet-e-studimit-10-18/5/380">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/programet-e-studimit-10-18/5/380</a>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, konstatohet që ata marrin këshillimin dhe</p>



<p>sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>mbështetjen e nevojshme përgjatë kohëvazhdimit të procesit mësimor të programit të studimit (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>). Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këtë qëllim, ku rol kryesor luan departamenti dhe stafi akademik, zyrat e administratës së IAL, Zyra e planifikimit të karrierës, këshilltari akademik dhe këshilltari i karrierës, të cilët udhëzojnë studentët mbi anën akademike të procesit, zgjedhjen e lëndëve, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (<i>Evidenca 2, nenet 4 e 63; Evidenca 9, neni 26; Evidenca 42</i>).</p> <p>Platformat e komunikimit janë të larmishme dhe synojnë shkëmbimin e saktë dhe të shpejtë të informacioneve të ndryshëm, përmes faqes zyrtare të IAL <i>online</i>, rrjeteve sociale të komunikimit, postës elektronike dhe njoftimeve nga instruktorët (<i>Evidenca 26</i>). Përgjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, KUB ka miratuar në mënyrë të menjëhershme platformën elektronike e-learning, e cila është përdorur gjatë gjithë procesit të mësimdhënies (<i>Evidenca 16</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Ndër njësitë e ngritura brenda strukturës së KUB është Zyra e Planifikimit të Karrierës (<i>Evidenca 2, neni 4</i>). Nëpërmjet zyrës së planifikimit studentëve u jepet mbështetje dhe ndihmë psikologjike, duke mbrojtur të drejtën e tyre të privatësisë. Zyra në fjalë ndihmon studentët që të kuptojnë pikat e tyre të forta akademike dhe rritjen e potencialit të të nxënit, të nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës, të lehtësojë procesin e rritjes së dijeve duke krijuar një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues midis studentëve, personelit akademik dhe personelit mbështetës. Kjo zyrë organizon takime prezantuese mes studentëve të diplomuar dhe institucioneve të ndryshme në sektorë të ndryshëm, informim të studentëve me profesionet përkatëse, mundësitë e karrierës, vendosjen e lidhjeve mes institucioneve që kërkojnë persona për të punësuar dhe studentëve, informon studentët nëpërmjet organizimit të seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake. Ndër prioritetet e zyrës së planifikimit të karrierës është edhe organizimi i aktiviteteve, të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre. Kjo zyrë krijon edhe <i>database</i>, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, mbi studentët dhe të diplomuarit e Kolegjit Universitar Bedër. Të dhënat mbi këtë zyrë mund të aksesohen online, në faqen zyrtare të IAL: <a href="http://career.beder.edu.al/">http://career.beder.edu.al/</a>. Në këtë zyrë, çdo departament ka emëruar një këshilltar për planifikimin e karrierës, që jep këshillime për studentët e regjistruar (<i>Evidenca 83</i>).</p> <p>Detyrat e kësaj zyre përmenden dhe në nenin 41 të rregullores për organizimin administrativ, sjellë së fundmi nga institucioni (<i>Evidenca shtesë 3 "Rregullore mbi organizimin administrativ"</i>).</p>



	<p>Sipas akteve të sjellë nga instiucioni, konstatohet se ka miratuar procedurën e praktikës profesionale si dhe procedurën për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës, duke sjellë në rrugë elektronike këto akte (<i>Evidenca shesë 4 "Procedura e praktikës profesionale"; Evidenca shesë 5 "Procedura për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës"</i>). Nga shqyrtimi i përmbajtjes së tyre, vlerësohet se aktet janë në funksion të qartësimi të procesit të punës që duhet të ndjekë zyra e planifikimit të karrierës.</p> <p>Këshilltari akademik dhe këshilltari i karrierës, udhëzojnë studentët mbi anën akademike të procesit, zgjedhjen e lëndëve, ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (<i>Evidenca 6, neni 18; Evidenca 9, neni 26; Evidenca 42</i>).</p> <p>Institucioni siguron gjithashtu këshillimin për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët (<i>Evidenca 2, nenet 104 e 105; Evidenca 23, f. 26</i>). Rregullorja për praktikën është miratuar nga kolegji dhe është sjellë në rrugë elektronike prej tij (<i>Evidenca shesë 4 "Procedura e praktikës profesionale"</i>).</p> <p>Institucioni ka lidhur disa marrëveshje me institucione publike e private, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale (<i>Evidenca 57</i>). <i>GVJ, në lidhje me këtë kriter, vlerëson të rekomandojë lidhjen e marrëveshjeve dhe me institucione e organe të tjerë, të specializuar sipas fushave të së drejtës, në përputhje me profilizimet e këtij programi studimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e karrierës siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë (<i>RVB, f. 65</i>). Në funksion të veprimtarisë së kësaj zyre, është miratuar procedura për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës (<i>Evidenca shesë 5 "Procedura për gjurmimin e të diplomuarve dhe zhvillimin e karrierës"</i>).</p> <p>Në varësi të Dekanatit të studentëve është krijuar dhe Zyra e të diplomuarve, e cila mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve që i përkasin këtij programi studimi (<i>Evidenca 75</i>).</p> <p>Sikundër vërehet nga evidencat e cituara mbi statistikat e punësimeve, këto të dhëna iu vihen në dispozicion organeve drejtuese të IAL. Plani i punës së kësaj zyre dhe koha e aktiviteteve prezantohen tek rektori i universitetit. Të dhëna të tjera mbi veprimtarinë e kësaj zyre, mbi alumni-t, mundësitë për punësim, etj., mund të aksesohen dhe online në faqen zyrtare të universitetit: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/content/default/dekanati-i-studenteve-3/424/425">https://www.beder.edu.al/sh/content/default/dekanati-i-studenteve-3/424/425</a>.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

### Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sipas përcaktimeve ligjore të nenit 103 e vijues të ligjit Nr. 80/2015, KUB ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në nenet 28-29 të statutit, nenin 16 të Rregullores themelore, nenin 20 të Rregullores së fakultetit ( <i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca 5</i> ). Në përputhje me këto parashikime, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional. Detyrat e njëjve lidhen me garantimin e plotësimit të standardeve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit. Institucioni ka hartuar dokumentet përkatës që mundësojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë ( <i>Evidenca 10; Evidenca 8</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në vijim të parashikimeve të bëra në statutin e tij, në strukturat e KUB përfshihet Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë njësi është anëtar dhe një përfaqësues i këshillit studentor ( <i>Evidenca 1, nenet 28-29</i> ). Këtë veprimtari, kjo njësi e kryen në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, ku njëri prej anëtarëve vjen nga studentët ( <i>Evidenca 2, neni 14</i> ).  Sa i përket strategjisë, rëndësia që i ka dhënë IAL nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në strategjinë institucionale ( <i>Evidenca 3</i> ),



	<p>por politika të detajuara janë shprehur në rregulloren për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 10</i>).</p> <p>Në këtë proces dhe struktura janë përfshirë dhe studentët (<i>Evidenca 76</i>) (garantuar nga parashikimi përkatës në statutin e IAL), të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 28 i statudit (<i>Evidenca 1</i>).</p> <p><b><i>GVJ rekomandon angazhimin dhe të një përfaqësuesi nga institucionet me të cilët bashkëpunon institucioni për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve (<i>Evidenca 11</i>). Informacioni që institucioni siguron nga studentët lidhet me aspekte të mësimdhënies, të programeve dhe të lëndëve mësimore. Metodatat që përdoren janë anketat (<i>Evidenca 11, neni 2</i>).</p> <p>Vlerësimi që kryhet nga stafi akademik lidhet me aspekte të programeve, lëndëve dhe mësimdhënies. Metodatat që përdoren janë anketa dhe formulari i vetëvlerësimit (<i>Evidenca 11, neni 3</i>). Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me ekspertë të huaj, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Në nenet 28 e 29 të statudit KUB ka paraqitur politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit (<i>Evidenca 1</i>), të shtjelluara në mënyrë të hollësishme dhe në rregulloren e NJSBC dhe të Komisionit të përhershëm (<i>Evidenca 10; Evidenca 8</i>). Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Njësia e Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo njësi organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit. Mbi bazën e të dhënave të marra nga pyetësori studentor dhe informacioneve të tjerë, hartohet raporti i vlerësimit vjetor (<i>Evidenca 1, neni 29; Evidenca 10</i>). Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik, departamenti harton raportin vjetor, ku përfshihen të dhëna përshkruese si dhe sasiore mbi programin e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin</p>



akademik, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e studentëve, kalueshmërinë dhe notën mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe masat për t'u ndërmarrë në të ardhmen (Evidenca 23).

Në këtë mënyrë, kontrolli mbi cilësinë nis nga niveli bazë e më pas kalon në rang institucional, duke përfshirë të gjithë hallkat e IAL. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë ndërmjetëson, harton dhe jep raporte për aktivitete dhe nisma të reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e KUB si dhe realizon koordinimin e procesit të brendshëm të cilësisë. Funkcionimi i Komisionit rregullohet nga Rregullorja përkatëse, e hartuar dhe miratuar në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Përgjegjësitë kryesore të Komisionit kanë të bëjnë me:

- Organizimin e një rrjeti cilësie të brendshëm;
- Nxitjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet njësive;
- Zhvillimin e procesit të të nxënimit në tri hapa;
- Riorganizimin e aftësive specifike në institucion;
- Promovimin e ideve inovatore me qëllim zgjidhjen e problemeve;
- Matjen dhe evidentimin e përmirësimeve në arritjen e cilësisë;
- Sigurimin e cilësisë;
- Analizimin e raporteve të përvitshme të secilës njësi, në bashkëpunim me NJSBC;
- Auditimin e aktiviteteve në bashkëpunim me NJSBC (Evidenca 8, neni 12).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes			
	Niveli i ulët	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Nga aktet rezulton që struktura përgjegjëse në nivel institucional për monitorimin e cilësisë është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit, i cili zgjidhet nga senati akademik, me misionin e zhvillimit dhe forcimit të sistemit të cilësisë në KUB në mënyrë që t'i shërbejë nevojave të komunitetit universitar dhe organeve të tjera të interesuara që lidhen me cilësinë e



	<p>institucionit dhe programet e studimit të ofruara nga KUB (<i>Evidenca 1, neni 27</i>). Ky komision është përgjegjës për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme, kërkimin shkencor dhe vetë universitetin. Komisioni mbikëqyr dhe harton rregulloret, politikat, programet, proceset akademike dhe joakademike, si dhe siguron respektimin e kornizës ligjore duke siguruar cilësi në KUB në bashkëpunim me të gjithë partnerët institucionalë dhe palët e interesuara (<i>Evidenca 8, nenet 3, 10</i>).</p> <p>Komisioni ka në përbërje të tij pesë anëtarë, nga të cilët një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm (<i>Evidenca 2, neni 14</i>). Në nivel të njësisë bazë, të gjitha veprimtaritë e departamentit përfshihen në raportin vjetor të departamentit (<i>Evidenca 8</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në KUB planifikojnë dhe organizojnë vlerësimin e brendshëm të cilësisë si për programet e studimit, ashtu dhe për institucionin. Kryerja e procedurave, përmes mekanizmave të përcaktuar nga këto struktura, bëhet në mënyrë periodike mbi programin e studimit të ciklit të dytë. Drejtimet e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në manualin për sigurimin e cilësisë dhe përfshijnë vlerësimet e studentëve në bazë kursi, vlerësimet e personelit akademik për njëri-tjetrin, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë të departamentit në fund të vitit akademik (<i>Evidenca 10; Evidenca 11; Evidenca 23, f. 29-31</i>). Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi (<i>Evidenca 15</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aktet e brendshëm për sigurimin e cilësisë, institucioni ka parashikuar shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit. <i>GVJ vlerëson të sugjerojë rishikimin dhe përmirësimin e rregullores për anketat dhe vlerësimin, sikundër kërkon neni 14 i Rregullores për funksionimin dhe organizimin e NJSBC, ku të specifikohen qartë dhe saktë metodat për kryerjen e vlerësimit (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta), indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik e në tërësi instrumentet matës dhe vlerësues.</i> Në tërësi këto mjete përdoren nga Komisioni për sigurimin e cilësisë si dhe zyra e sigurimit të cilësisë, në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve (<i>Evidenca 8</i>). Mekanizmat e përdorur janë procesi i vlerësimit të studentëve, përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të mësuarit, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i</p>




	vetëvlerësimi të pedagogëve ( <i>Evidenca 11; Evidenca 29; Evidenca 30; Evidenca 31; Evidenca 32; Evidenca shitesë "Anketë vlerësimi i studentëve për institucionin new"</i> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Në përfundim të procesit të vlerësimit, si në rang departamenti, ashtu dhe institucional, të dhënat e grumbulluara përpunohen dhe dokumentohen në aktet e mbajtur për këtë qëllim, të cilët më pas dërgohen në instancat përgjegjëse për vendimmarrje të mëtejshme (<i>Evidenca 8; Evidenca 10</i>).</p> <p>Në mënyrë më të detajuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në rastin kur propozohen ndryshime në programin e studimit (kurrikulat), informacioni shkresor dërgohet pranë zyrës së kurrikulave dhe komisionit për kurrikulat dhe mësimin. Nëse vlerësohen ndryshimet e kurrikulave, akti përkatës i dërgohet për miratim senatit (<i>Evidenca 15, neni 3</i>).</li> <li>- Në nivel institucional, të dhënat e vlerësimit NJSBC i përpunon dhe i dërgon pranë Komisionit për Vlerësim Institucional, i cili më pas e përcjell në Senat, me qëllim marrjen e vendimeve në funksion të përmirësimeve të nevojshme (<i>Evidenca 10; Evidenca 8</i>).</li> </ul> <p>Hartimi i raportit dhe procedurat për njohjen me të nga autoritetet përgjegjëse janë shtjelluar në rregulloren e NJSBC (<i>Evidenca 10</i>).</p> <p>Të gjitha informacionet në lidhje me politikat dhe praktikat për sigurimin e cilësisë në KUB janë të arritshme për të gjitha grupet dhe njësitë e interesuara përfshirë organet e studentëve, në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/raporti-vjetor--14-3/188/687">https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/raporti-vjetor--14-3/188/687</a>.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	<p>Në aktet për sigurimin e cilësisë janë përcaktuar elementet që duhet të përmbajë raporti vjetor i vlerësimit. Raporti duhet të përmbajë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik. Përfundimet e nxjerrë shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (<i>Evidenca 8; Evidenca 10</i>).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	



**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion vërehet që programi i studimit vlerësohet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë në nivel departamenti. Në përfundim të vitit akademik, mblidhen të dhënat sipas burimeve të përcaktuar në manualin për sigurimin e cilësisë, informacioni i cili përfshihet më pas në raportin vjetor të departamentit, që vlerëson mësimdhënien, të nxënit, transparencën e notave dhe standarde të tjerë të cilësisë. Rezultatet e performancës, me propozimet përkatës, i dorëzohen Komisionit të Përhershëm të Cilësisë dhe senatit akademik. Raporti bëhet në vijim pjesë e raportit vjetor mbi ecurinë akademike si dhe e vetëvlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional (<i>Evidenca 8; Evidenca 10; Evidenca 6.2; Evidenca 6.10; Evidenca 6.10.1</i>).</p> <p>Nëse shihet e nevojshme të ndryshohet kurrikula e programit apo të përmirësohet ajo, niset procedura e përcaktuar në udhëzuesin përkatës. Në procedurën e rishikimit të kurrikulës përfshihen ekspertë të jashtëm, studentë, alumni, për të diskutuar mbi gjithë problematikat e konstatuara (<i>Evidenca 15</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar në aktet e brendshme instrumentet që do të përdoren për kryerjen e vlerësimit, ku përmenden vetëm anketat (<i>Evidenca 11</i>). Gjithashtu, në të njëjtin dokument janë specifikuar drejtimet dhe metodat për kryerjen e matjeve dhe vlerësimit si dhe indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik (<i>Evidenca 11</i>). Duke qenë se instrumentet dhe metodat shërbejnë për hartimin e raportit vlerësues të programit të studimit dhe përmirësimit të tij, nëse rezultoni e nevojshme, GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë të kriteri 3, Standardi VI.2, për plotësimin e rregullores për ankesat dhe vlerësimet, ku të specifikohen qartë dhe në mënyrë të plotë metodat për kryerjen e vlerësimit, indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik e në tërësi instrumentet matës dhe vlerësues.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së</p>	<p>Metoda të drejtpërdrejta, të përmendura shprehimisht në aktet për sigurimin e cilësisë, nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë. Si metoda të tilla përmenden vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve nëpërmjet plotësimit të anketave përkatëse, vlerësimi i didaktikës nga kolegët. Metoda të tjera në këtë</p>





mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

drejtim janë përmendur në f. 69 të RVB për promovimin e mësimdhënies: vlerësimet e kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, testime, vëzhgime në auditor, etj.

*GVJ rekomandon që IAL të specifikojë metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë në rregulloren për anketat dhe vlerësimet, në mënyrë që të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.*

**Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program

Metoda të tërthorta të përmendura shprehimisht në aktet për sigurimin e cilësisë nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë.

Si metoda të tërthorta rezultojnë të përdoren: procesi i vlerësimit të studentëve, marrja e mendimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe për institucionin, marrja e mendimit nga personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ si dhe strukturave përgjegjëse (*Evidenca 29; Evidenca 30; Evidenca 31; Evidenca 32*).

*GVJ rekomandon që IAL të specifikojë metodat e tërthorta të vlerësimit të cilësisë në rregulloren për anketat dhe vlerësimet, në mënyrë që të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, në aktet e tij të brendshëm dhe në politikat e procedurat e brendshme të cilësisë, ka parashikuar dhe figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 1, neni 28; Evidenca 10, neni 6</i>).</p> <p>Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve (<i>Evidenca 29; Evidenca 32; Evidenca shtesë "Anketë vlerësimi i studentëve për institucionin new"; Evidenca 76</i>).</p> <p>Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 28 i Statutit (<i>Evidenca 1</i>) dhe neni 6 i Rregullores së NJSBC (<i>Evidenca 10</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni, në vijim të parashikimeve ligjore të aplikueshme, ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë, të nivelit bazë dhe institucional. Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenin 29 të statutit (<i>Evidenca 1</i>) si dhe në nenin 11 të Rregullores së NJSBC-së (<i>Evidenca 10</i>). Në nivel departamenti të këtij programi studimi, nuk ka përcaktime në rregulloren e programit, por në Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë përcaktohet se programet e studimit të ciklit të dytë kryejnë në fund të çdo viti vlerësimin e brendshëm dhe kërkojnë akreditimin në afatet e parashikuar në ligj (<i>Evidenca 9, neni 53</i>).</p> <p>Nga shqyrtimi i rregullimeve të brendshme konstatohet që, formalisht, ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë, është i garantuar (<i>Evidenca 10</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet e bëra nga statuti i KUB, neni 32, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë një nga anëtarët është përfaqësues i studentëve (<i>Evidenca 2, neni 14</i>). Po ashtu, në përbërje të NJSBC-së prej pesë anëtarësh, njëri prej tyre është përfaqësues i Këshillit Studentor (<i>Evidenca 1, neni 28</i>). Stafi akademik dhe administrativ marrin përsipër rolin kryesor në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Njësinë, duke siguruar përgjegjësinë institucionale. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces janë të informuar për rëndësinë e procesit të akreditimit dhe hapat që duhen ndjekur në guidat përkatëse (<i>Evidenca 24; Evidenca 25</i>). Senati ka përgjegjësinë finale për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. (<i>Evidenca 10, neni 11</i>).</p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas përcaktimeve statutorë dhe rregullores së nxjerrë për këtë qëllim, vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale. Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore të aplikueshme dhe në organizimin e brendshëm të institucionit. Duke mbajtur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve (<i>Evidenca 10</i>). Ky fakt nuk rezultoi as gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sipas nenit 6 të rregullores së NJSBC, një nga anëtarët e NJSBC, është ekspert i jashtëm (<i>Evidenca 10</i>). Në RVB, f. 70, referohet se njësitë bazë organizojnë takime këshillimi me profesionistë të fushës për t'u informuar mbi dinamikën e tregut të punës si dhe ekspertë të jashtëm janë angazhuar dhe në procesin e hartimit të programeve të studimit (<i>Evidenca shtesë "Shënimet Drejtësi Bedër"</i>).</p> <p><i>GVJ e sheh të arsyeshme të sugjerojë që, në hartimin e raportit të vlerësimit, të angazhohet dhe një përfaqësues nga njëri prej institucioneve të bashkëpunimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike</p>	<p>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të KUB, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar. Sipas përcaktimeve të nenit 18 të rregullores së NJSBC, të dhënat, raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe raporti i komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë,</p>



<p>për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>publikohen në faqen zyrtare të KUB (<i>Evidenca 10</i>). Raportet në fjalë gjenden në faqen elektronike të institucionit: <a href="https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/procesi-i-akreditimit-2/188/200">https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/procesi-i-akreditimit-2/188/200</a>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të KUB. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të KUB si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale (<i>Evidenca 29; Evidenca 30; Evidenca 31; Evidenca 32; Evidenca shtesë "Anketë vlerësimi i studentëve për institucionin new"</i>). Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave të sakta mbi programet e studimit dhe përmirësimi i këtyre të fundit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni i përdor të dhënat që dalin nga vlerësimi i stafit akademik në funksion të rritjes së cilësisë së procesit akademik, por jo vetëm. Të gjitha të dhënat që dalin nga pyetësorët, anketimet, etj., shërbejnë për hartimin në vijim të planit të masave që duhen marrë në vijim nga strukturat drejtuese të universitetit në rang fakulteti dhe në rang institucional (<i>Evidenca 8; Evidenca 10; Evidenca 3</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e rregullimeve specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave në rrjedhim të veprimtarive që monitorojnë vlerësimin e cilësisë nga ana e institucionit, dëshmon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. Sipas nenit 2 në lidhje me nenin 11 të rregullores së NJSBC, nëpërmjet procesit vlerësues synohet të përcaktohet niveli i cilësisë së arritur, evidentimi i praktikave pozitive, përmirësimi, ndryshimi dhe promovimi i zhvillimeve pozitive, marrja e vendimeve efikase (<i>Evidenca 10</i>).</p> <p>Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë (<i>Evidenca 3; Evidenca 15</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion se institucioni ka organizuar veprimtari në vijimësi me personelin, por dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi e më gjerë, në vazhdimësi. Në funksion të plotësisë të këtij kriteri vlejné të dhënat që hedhin dritë mbi procesin në fjalë në guidat e miratuara për këtë qëllim për stafin akademik dhe studentët (<i>Evidenca 24; Evidenca 25; Evidenca 10, neni 11</i>).</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përkrahje përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Master i Shkencave në: Drejtësi në profilet “E drejtë penale”; “E drejtë ndërkombëtare” të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Institucioni ka grumbulluar tashmë një eksperiencë të vlefshme në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të programeve të ciklit të dytë të studimeve, sic është programi në vlerësim; një eksperiencë e tillë është themelore për të adresuar e përballuar sfidat dhe vështirësitë eventuale;
2. Institucioni mbështet programin në vlerësim dhe në tërësi të gjithë veprimtaritë e tij akademike, shkencore e administrative mbi një strukturë të mirëorganizuar e funksionale që është një tregues i rëndësishëm në drejtim të qëndrueshmërisë institucionale dhe të aktiviteteve që realizon;
3. Personeli akademik i angazhuar pranë programit, sidomos në 2 vitet e fundit, është përgjithësisht me eksperiencë të gjatë në institucionet e arsimit të lartë apo në sektorin e drejtësisë, një faktor me rëndësi të vecantë për përmbushjen e objektivave në lidhje me cilësinë e programit të ofruar;
4. Qëndrimi dhe kontaktet me përfaqësuesit e institucionit janë të hapura ndaj sugjerimeve e observimeve, tregues i përkushtimit të sinqertë për të adresuar ndryshimet e nevojshme dhe arritur objektivat e procesit të akreditimit;
5. Institucioni disponon ambiente të bollshme dhe me standardet e duhura për zhvillimin e programit të studimit, e pajisur me mjetet e përshtatshëm nga pikëpamja logjistike, por edhe nga pikëpamja rekreative;
6. Biblioteka garanton një akses të bollshëm në literaturën e nevojshme të programit dhe fushës së drejtësisë në përgjithësi, si fizikisht ashtu edhe online;
7. Institucioni ka arritur të përshtasë punën e stafit akademik dhe administrativ me gjendjen e krijuar për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 si dhe të sigurojë mësimdhënien në platformat elektronike dhe komunikimin me studentët edhe në distancë;




**b. Pika të dobëta:**

1. Sfida kryesore mbetet interesi në rënie i studentëve për programe Master Shkencor 2 vjecarë të ciklit të dytë të studimeve; programet e integruara të studimit 5 vjecar në fushën e drejtësisë (programe në fund të të cilave përfitohet diploma Mastër i Shkencave) që janë tashmë në fuqi në të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik dhe jo publik do të shuajnë gradualisht kërkesën për programe 2 vjecare Master i Shkencave;
2. Rekrutimi i personelit të brendshëm akademik (efektiv) me tituj ose të paktën gradë shkencore Dr. Shkencave mbetet ende një objektiv për t'u arritur dhe, sidomos, ruajtur në mënyrë të qëndrueshme;
3. Marrëveshjet e bashkëpunimit mbeten të kufizuara; kjo ka një ndikim edhe në realizimin e praktikave profesionale në institucione që realizojnë një aktivitet të vlefshëm në drejtim të objektivave mësimorë të programit të ofruar;
4. Mungon një plan veprimi i detajuar për Komisionin dhe Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, rregullorja për anketat dhe vlerësimet paraqet mangësi, sic është përshkruar në teks;

**Rekomandime**

1. Në kuadër përshtatjes me ndryshimet ligjore për kalimin në programin e integruar 5 vjeçar në drejtësi rekomandohet të bëhet një vlerësim/analizë dhe planifikim për ecurinë e mëtejshme të programit, si do të orientohet në kushtet e reja, tregun dhe nevojat e tij, etj.
2. Rekomandohet shtimi i përpjekjeve për të afruar pranë programit personel të brendshëm akademik (efektiv) të paktën me gradë shkencore Dr. Shkencave për të forcuar qëndrueshmërinë e tij.
3. Rekomandohet një vemendje e shtuar mbi kurrikulën e dy drejtimeve të programit për të evituar paqartësitë në lidhje me disa komponentë të tij dhe forcuar lidhjen e kurrikulës me objektivat e dy drejtimeve të programit të studimit.
4. Rekomandohet shtimi i përpjekjeve për të aplikuar në projekte ndërkombëtare, me qëllim fuqizimin e pjesëmarrjes në projekte kërkimore.
5. Rekomandohet të lidhen marrëveshje me institucione dhe organe të tjerë të specializuar sipas fushave të së drejtës, në përputhje me profilizimet e këtij programi studimi.
6. Rekomandohet shtimi i marrëveshjeve me IAL të huaja, të cilat do të ndihmonin kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor, në përputhje me drejtimet e studimit të këtij programi studimi.
7. Rekomandohet që institucioni të marrë masat e nevojshme për të hartuar një plan veprimi i qartë mbi veprimtarinë e Komisionit dhe Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, të rishikohen me qëllim përmirësimi aktet e brendshme në funksion të sigurimit të cilësisë dhe plotësimin e standardeve të vendosur në këtë drejtim.






**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program of the Master of Science in:  
Law with profiles "Criminal Law"; "International Law"**

**a. Strengths:**

1. The institution has already accumulated a valuable experience in setting up and developing academic programs of the second cycle of studies, such as the program under evaluation; such experience is fundamental to face and address challenges and eventual difficulties.
2. The institution supports the program under evaluation and, generally, all academic, scientific and administrative activities, through a well-organized and functional body structure, an important indicator of institutional sustainability and the activities it carries out.
3. The academic personnel engaged in the program, especially in the last 2 years, have, generally, a long experience in higher education institutions or in the justice sector, a factor of special importance for the fulfillment of the objectives related to the quality of the offered program.
4. The attitude and communication with the representatives of the institution are characterized by an open approach to ideas and observations, an indication of sincere commitment to address the necessary changes and achieve the objectives of the accreditation process.
5. The institution has ample premises and of proper standards for the development of the program, equipped with suitable tools from a logistical as well as a recreational point of view.
6. The library provides ample access to the necessary literature of the program and the field of law in general, both physically and online.
7. The institution has managed to adapt the work of academic and administrative staff to the situation created due to Covid-19 pandemic, as well as to ensure continuation of the teaching on electronic platforms and communication with students even remotely.

**b. Weaknesses:**



1. The main challenge remains the decreasing interest of students in 2-year Master of Science programs of the second cycle of studies; the current application of the integrated 5-year study programs in the field of law (programs at the end of which a Master of Science degree is obtained) in all public and non-public higher education institutions will gradually extinguish the demand for 2-year Master of Science programs.
2. Recruitment of internal academic staff (full time) with an academic title, or at least a PHD degree, remains an objective to be achieved and, especially, to be maintained in a sustainable manner.
3. The number of cooperation agreements remains limited; this has also an impact on the accomplishment of professional practices in those institutions which carry out activities that could be useful for meeting the educational objectives of the offered program.
4. A detailed action plan for the Commission and the Internal Quality Assurance Unit is lacking. Also, the regulation for surveys and evaluations presents deficiencies, as explained in the text.





## Recommendations:

1. In the context of adapting to the legal changes for the transition to the 5-year integrated program in law, it is recommended that the Institution makes an assessment/analysis and planning for the further progress of the program, how it would be oriented in view of the new conditions, the market needs, etc;
2. It is recommended to increase efforts to bring to the program internal academic staff (full time) with at least a PHD degree, to strengthen the sustainability of the program;
3. An increased attention on the curriculum of the two streams of the program is recommended, in order to avoid ambiguities regarding some parts of the curriculum of the program and to strengthen its connection with the objectives of the two streams;
4. It is recommended to increase efforts to apply to international projects, in order to strengthen participation in research projects;
5. It is recommended to conclude agreements with institutions and other specialized bodies in the area of law, in accordance with the profiles of the program;
6. It is recommended to increase the number of agreements with foreign higher education institutions, which would help to advance professional qualification of the academic and non- academic staff, in accordance with the profile of the streams the program;
7. It is recommended to take the necessary measures to draw up a clear action plan on the activity of the Commission and the Internal Quality Assurance Unit. Furthermore, it is recommended to revise the internal acts in order to improve them and to ensure quality, in line with the standards established in this direction;





Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

